



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI DHE KRYENEGOCIATOR

RAPORT MBI NEGOCIATAT DHE INTEGRIMIN EVROPIAN
(Periudha raportuese: prill – qershor 2024)

Korrik 2024

PASQYRA E LËNDËS

HYRJE	3
PJESA I: KUADRI PËR INTEGRIMIN EVROPIAN	4
1.1 VIZIONI STRATEGJIK.....	7
1.2 SFIDAT	10
1.3 INTEGRIMI I PËRSHPEJTUAR	15
1.4 MARRËVESHJA E STABILIZIM-ASOCIIMIT.....	21
PJESA II: NEGOCIATAT PËR ANËTARËSIMIN NË BASHKIMIN EVROPIAN	28
2.1 GRUPIMI I KAPITUJVE1 “THEMELORET”	21
2.2 GRUPIMI I KAPITUJVE 2 “TREGU I BRENDSHËM”	36
2.3 GRUPIMI I KAPITUJVE 3 “KONKURRUESHMËRIA DHE RITJA GJITHËPËRFSHIRËSE”	39
2.4 GRUPIMI I KAPITUJVE 4 “AGJENDA E GJELBËR DHE LIDHSHMËRIA E QËNDRUESHME”	46
2.5 GRUPIMI I KAPITUJVE 5 “BURIMET, BUJQËSIA DHE KOHEZIONI”	48
2.6 GRUPIMI I KAPITUJVE 6 “MARRËDHËNIET ME JASHTË”	49
PJESA III: PJESËMARRJA E GRUPEVE TË INTERESIT NË PROCESIN E NEGOCIATAVE DHE INTEGRIMIT EVROPIAN	76
PJESA IV: INTEGRIMI EVROPIAN NË NIVEL VENDOR	83

HYRJE

Raporti për “Negociatat dhe Integrimin Evropian”, drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, hartohet në zbatim të nenit 19, të ligjit nr.19/2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”.

Ky raport periodik për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë bazohet në detyrimin ligjor, të përcaktuar si më sipër, dhe paraqet: I) progresin në zbatim të detyrimeve për ‘Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit’; II) procesin e negociatave, në përputhje me Paketën e Zgjerimit të Komisionit Evropian¹; III) vizionin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030; si dhe programin e Qeverisë Shqiptare 2021 – 2024; IV) integrimin e përsheptuar, përmes Planit të Rritjes së Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor dhe të tjera zhvillime.

Raporti për periudhën prill – qershor 2024 paraqet një pasqyrë zhvillimore të progresit dhe arritjeve në procesin e negociatave dhe integritit evropian në nivelin (i) qendror dhe nivelin (ii) vendor, me qëllim arritjen e objektivit madhor për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Ky Raport është hartuar nga Departamenti i Politikës dhe Integritit Evropian në Kryeministri, në funksionin e tij si Sekretariat Përgjithshëm i Integritit Evropian, nën drejtimin e strukturës negociuese Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator, negociatorët dhe 36 sekretariatet teknike të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës të Integritit Evropian (GNPIE-së), për çdo kapitull (grupkapitull) dhe kriter të acquis të Bashkimit Evropian.

¹ https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_22_6082

PJESA I: KUADRI PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

1.1 Vizioni strategjik

Integrimi Evropian është synimi politik dhe strategjik më i rëndësishëm i Shqipërisë dhe i sistemeve të saj ligjore, ekonomike dhe institucionale.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrimin Evropian (SKZHIE) 2022-2030, përcakton vizionin dhe objektivat strategjike kombëtare, ku qëllimi parësor strategjik është integrimi evropian.

Procesi i negociatave dhe më pas, anëtarësimi në Bashkimin Evropian, mbështet më tej demokratizimin dhe forcimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri, nxit konsolidimin e sistemit publik dhe vazhdimin e proceseve reformuese, duke përshpejtuar zhvillimin ekonomik dhe përqasjen me nivelet më të mira evropiane të mirëqenies dhe social.

1.2 Sfidat

Metodologjia e re e anëtarësimit kërkon vazhdimësinë e reformave dhe politikave të koordinuara dhe të njëkohshme në të gjithë sektorët, për plotësimin e kriterëve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian (deri në 2030) gjatë negociatave dhe njëkohësisht dhe detyrimeve të MSA-së. Sfidat kryesore lidhen me domosdoshmërinë për: (i) konsolidimin e mëtejshëm dhe thellimin në reformat themelore; (ii) përmbushjen e detyrimeve të MSA-së dhe harmonizimit të mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së; (iii) mbas finalizimit të procesit screening, plotësimin e kriterëve për hapjen, zhvillimin dhe mbylljen e negociatave në grupimin 'Themeloret' dhe më pas në grupimet e tjera; (iv) koordinimin dhe integrimin vertikal dhe horizontal të politikave dhe reformave të lidhura me procesin e anëtarësimit.

1.3 Integrimi i Përshpejtuar

Komisioni Evropian, më 8 nëntor 2023, në kuadër të Paketës së Zgjerimit 2023, lancoi nismën për propozimin e Planit të Ri të Rritjes për Ballkanin Perëndimor (BP)², pjesë e të cilit është dhe mbështetja përmes Instrumentit “Faciliteti për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor”. Kjo iniciativë e re zhvillimore do të ofrojë mbështetje financiare deri në 6 miliardë Euro për periudhën 2024-2027 për të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (BP). Instrumenti “Faciliteti për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor” mbështet shtyllën e tretë³ dhe të katërt⁴ të Planit të Rritjes së Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor.

Synimi është përshpejtimi i konvergjencës socio-ekonomike të Ballkanit Perëndimor krahasimisht me vendet anëtare të Bashkimit Evropian, thelluar sidomos nga pasojat që erdhën nga kriza ekonomike si pasojë e pandemisë Covid-19 si dhe kriza energjetike globale, si pasojë e agresionit rus në Ukrainë, përmes nxitjes me objektiv dyfishimin e rritjes ekonomike.

Ky instrument është miratuar më 14 maj 2024 përmes Rregullores 2024/1449 të Bashkimit Evropian “Për miratimin e Facilitetit të Reformave dhe Rritjes për Ballkanin Perëndimor”.

Dokumenti i politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024-2027” (AKR 2024-2027) konsiderohet si një instrument i rëndësishëm që do të nxisë përgatitjet ekonomike të orientuara nga tregu për përshpejtimin e integritit të ekonomisë shqiptare në Tregun e Vetëm të BE-së, drejt progresit në konvergjencë me vendet anëtare të BE-së dhe vjen si kërkesë e kreut III të Rregullores⁵ 2024/1449 të Bashkimit Evropian.

Prioritetet e reformave të përcaktuara në AKR 2024-2027 janë në përputhje me drejtimit prioritar që përcakton Plani i Ri i Rritjes për Ballkanin Perëndimor⁶, me qëllim përshpejtimin e integritit të ekonomisë shqiptare në Tregun Unik të BE-së, përshpejtimin e integritit të vendit në BE, si dhe thellimin e integritit ekonomik rajonal, me objektiv kryesor mbështetjen për dyfishimin e rritjes ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Faza aktuale e procesit të negociatave dhe integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian e bën të qartë nevojën e ngushtimit të hendekut të konvergjencës ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së, në drejtim të zhvillimit social-ekonomik të vendit. AKR 2024-2027 adreson sfidën e rritjes së shkallës së integritit të ekonomisë kombëtare dhe asaj rajonale në Tregun e Vetëm të BE-së (TVBE), rritjes së produktivitetit të ekonomisë shqiptare, rritjes së aftësive të bizneseve dhe fuqisë punëtore, etj.

Prandaj, fokusi kryesor i AKR 2024-2027 është përmirësimi i klimës së favorshme ndaj biznesit dhe nxitja për rritjen ekonomike, nëpërmjet reformave për shtetin e së drejtës dhe të transformimit dhe ristrukturimit të ekonomisë, me burime kryesore të rritjes në kapitalin

² Reform and Growth Facility (RGF) for Western Balkan - Rregullorja 2024/1449 e Bashkimit Evropian

³ 2 Shtylla 3 e Planit të Ri të Rritjes për Ballkanin Perëndimor: Përshpejtimi i reformave themelore, duke përfshirë grupimin themelor, duke mbështetur rrugëtimin e BP drejt anëtarësimit në BE, duke përmirësuar rritjen e qëndrueshme ekonomike, duke përfshirë tërheqjen e investimeve të huaja dhe forcimin e stabilitetit rajonal.

⁴ Shtylla 4 e Planit të Ri të Rritjes për BP: Rritja e asistencës financiare për të mbështetur reformat nëpërmjet një Faciliteti për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor (RGF): një instrument i ri me vlerë 6 miliardë Euro me mbështetje të pakthyeshme (grant) dhe kredie, ku pagesa kushtëzohet me përmbushjen e reformave themelore nga partnerët e BP, dhe në veçanti reformat specifike socio-ekonomike.

⁵ https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=OJ%3AL_202401449 5 Reform and Growth Facility (RGF) for Western Balkan

⁶ https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/new-growth-plan-western-balkans_en

human, produktivitetin përmes specializimit dhe modernizimit, investimet dhe pjesëmarrjen në TVBE (përmes eksporteve, internacionalizimit dhe integritit të tregjeve sektoriale).

Dokumenti i politikës AKR 2024-2027 përcakton reforma dhe politika sipas drejtimeve të mëposhtme:

- a) Politika me në qendër biznesin: masa në adresim të sfidave kombëtare për tregun, forcimin e biznesit dhe ekonomisë, me synimin rritjen e aftësisë konkurruese në tregjet rajonale dhe përsheptimin e integritit në TVBE.
- b) Qasje “Treg me Treg”: duke i shërbyer integritit të tregut shqiptar në TVBE, që përbën burim të rëndësishëm për rritje ekonomike, për të lehtësuar aksesin e bizneseve kombëtare në TVBE, si dhe bashkëpunimit në tregun rajonal.
- c) Transformim ekonomik: përfshin masa dhe hapa që nxisin, gjenerojne dhe kanë impakt për inovacion, specializim të zgjuar, transformimi tregu dhe aftësisë dhe tranzicion energjitik/digjital për një rritje ekonomike të qëndrueshme.
- d) Realizueshmëri dhe masa realiste: masa që gjenerojnë rezultat dhe impakt, si dhe janë transformuese e sfiduese, por të arritshme me përpjekje të shtuara.

AKR 2024-2027 është një dokument politike reformash thelbësore të nxitjes së rritjes dhe transformimit ekonomik dhe konsolidimit të vlerave të shtetit të së drejtës. Dokumenti i politikës AKR 2024-2027, ofron një përmbledhje masash të përzgjedhura nga dialogu institucional Shqipëri - BE dhe hapash për krijimin e mjedisit të favorshëm për konsolidimin e transformimin ekonomik të vendit, i cili është i domosdoshëm për të rritur ritmin e rritjes dhe konvergjencës socio-ekonomike me vendet anëtare të BE-së në rrugën e anëtarësimit në BE.

AKR 2024-2027 përfshin masa që lidhen me prioritetet në fushat/shtyllat e politikave si më poshtë vijon:

1. Klima e Biznesit
2. Kapitali Njerëzor
3. Energjia / Tranzicioni i Gjelbër
4. Tranzicioni Digjital
5. Shteti i së drejtës / Themeloret

Qëllimi kryesor i dokumentit të politikës AKR 2024-2027 është të ndikojë dhe stimulojë çlirimin e potencialit ekonomik të vendit, përmes mbështetjes së transformimit ekonomik dhe përmirësimit të klimës së biznesit, fuqizimit të kapitalit njerëzor dhe agjendës së gjelbër (tranzicionit energjitik) dhe digjitale, për të hyrë gradualisht dhe i përgatitur në Tregun e Vetëm të BE-së, në themele solide dhe përmes forcimit të shtetit të së drejtës, me progres të vazhdueshëm në integrimin e përsheptuar, pakthyershmërisë së konsolidimit dhe efikasitetit të reformave themelore të ndërmarra, dhe ecjes së qëndrueshme përpara, në përmëshjen e kritereve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, deri në 2030.

Synimi kryesor i dokumentit të politikës AKR 2024-2027, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor”, është të kontribuojë dhe mbështetesë objektivin e Planit të Rritjes për dyfishimin e rritjes ekonomike në Shqipëri, nëpërmjet potencialit dhe konsolidimit të ndryshimeve strukturore të ekonomisë dhe modernizimit të saj, përmes avancimit të teknologjisë dhe dixhitalizimit, me burim të çmuar kapitalin human, dhe në bazat e qëndrueshme të reformave për shtetin e së drejtës.

Objektivat kryesorë të AKR 2024-2027 janë të shumfishta, duke përfshirë aspekte të ndryshme të qeverisjes, zhvillimit ekonomik dhe progresit shoqëror, si më poshtë vijon:

Objektivi 1: Rritja e konkurrueshmërisë dhe qeverisjes ekonomike kombëtare

Objektivi i parë është konsolidimi i reformave që mundësojnë e mbështesin transformimin e mëtejshëm të Shqipërisë në një ekonomi të qëndrueshme dhe konkurruese, e drejtuar nga qeverisje ekonomike transparente, infrastruktura ekonomike efikase dhe një kuadër ligjor i favorshëm për tërheqjen e investimeve dhe rritjen e eksporteve, që përputhet me *acquis* dhe praktikën më të mira të Bashkimit Evropian.

Ky objektivi përfshin disa iniciativa kryesore, të parashikuara si masa në dokumentin e politikës AKR 2024-2027, që nxisin një klimë biznesi edhe më konkurruese dhe tërheqëse, përmes një kornize kohezive dhe mbështetëse për zhvillimin ekonomik, përmes reformave si: (i) mobilizimi i të ardhurave të brendshme dhe përmirësimi i sistemit tatimor; (ii) sigurimi i transparencës dhe efikasitetit të shërbimeve shtetërore të kadastrës, për investitorët, bizneset dhe qytetarët dhe një politike publike gjithëpërfshirëse për përdorimin e tokës dhe pronës; (iii) rritja e tërheqjes dhe transparencës së investimeve dhe përmirësimi i qeverisjes së shoqërive me pronësi shtetërore dhe ndihmës shtetërore; (iv) përmirësimi i kornizës së tërheqjes së investimeve, në veçanti për IHD-të, dhe i klimës të biznesit nëpërmjet derregullimit dhe modernizimit të shërbimeve të biznesit; (v) vendosja e Sistemeve Inteligjente të Transportit dhe E-mallrave; (vi) promovimi i eksportit të produktit vendas drejt BE-së dhe ndërkombëtarizimi i ndërmarrjeve, duke përfshirë lehtësimin e tregtisë dhe transportit, me synim TVBE, si një bazë e gjerë konsumatore, (vii) partneritetin për zinxhirin e vlerës dhe rritjen, specializimin e zgjuar dhe formimin profesional, sipërmarrjen inovative.

Objektivi 2: Zhvillimi i qëndrueshëm i kapitalit njerëzor - reformimi i arsimit për një fuqi punëtore të kualifikuar dhe të përgatitur digjitalisht

Objektivi i dytë fokusohet në zhvillimin e kapitalit njerëzor, duke krijuar një sistem arsimor dinamik që pajis studentët me aftësitë përkatëse dhe kompetencën digjitale të nevojshme në ekonominë globale, duke nxitur inovacionin dhe rritjen e konkurrueshmërisë kombëtare dhe zhvillimin e produktivitetit dhe fuqisë punëtore të kualifikuar. Në kuadër të këtij objektivi, përvijohen iniciativa të ndryshme të parashikuara si masa në dokumentin e politikës AKR 2024-2027, për rritjen e efektivitetit të sistemit arsimor profesional, përafrimin e tij me kërkesat në përgjigje të zhvillimeve dinamike të tregut të punës dhe rritjen e pjesëmarrjes aktive në tregun e punës, si dhe, më gjerë, me zhvillimin e ekonomisë.

Reformat kryesore për arritjen e këtij objektivi konsistojnë në (i) rishikimin e sistemit të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) për ta përshtatur më mirë me kërkesën për aftësi të tregut të punës; (ii) përditësimin i kurrikulave në arsimin fillor dhe të mesëm për kompetencat e të mësuarit në përmbushje të Rekomandimit të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Strategjisë Kombëtare të Arsimit, 2021 – 2026; (iii) përmirësimin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve në përputhje me atë të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG⁷), si një nga angazhimet kryesore të Procesit të Bolonjës; (iv) përparimi në aftësitë dhe arsimin digjital për të rinjtë dhe infrastrukturën TIK për shkollat dhe universitetet publike; (v) forcimin e efikasitetit të skemave mbështetëse të politikës së punësimit; (vi) forcimi i mjedisit dhe ekosistemit kombëtar të kërkimit dhe inovacionit.

⁷ ESG - European Standards Guidelines

Objektivi 3: Ndërtimi i një shoqërie dixhitale të sigurt, të qëndrueshme dhe me shërbime të aksesueshme

Objektivi i tretë përqendrohet në transformimin dixhital, duke krijuar një shoqëri digjitale udhëheqëse të zhvillimit dhe rritjes, ku infrastrukturat dixhitale të sigurta, të qëndrueshme dhe efikase mbështesin shërbimet publike dhe transformimin ekonomik sigurojnë qëndrueshmëri kibernetike, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian. Për të arritur këtë objektiv, parashikohen në AKR 2024-2027 disa iniciativa kryesore, që konsistojnë në: (i) përafrimin me rregulloren e BE për Identitetin Digjital dhe zbatimin e E-Portofolit Digjital për shërbimet publike; (ii) përafrimin e kuadrit për përshtatshmërinë kibernetike, me standardet e BE dhe kërkesat Direktivës NIS2⁸ të Bashkimit Evropian; (iii) përmirësimin e kornizës për një infrastrukturë digjitale të sigurt dhe të qëndrueshme; (iv) përmirësimin e mjedisit mundësues për bizneset inovative dhe mbështetja e inicativave të bizneseve me potencial për tranzicionin e gjelbër dhe digjital, si dhe nxitjen dhe rritjen e ekosistemit të sipërmarrjes inovative.

Objektivi 4: Konsolidimi i qëndrueshmërisë energjitike dhe integrimi i tregut shqiptar në atë të BE-së

Objektivi i katërt fokusohet në energjinë dhe tranzicionin e gjelbër, me synimin për të transformuar Shqipërinë në një lider rajonal të energjisë, nëpërmjet adoptimit të standardeve dhe praktikave të Bashkimit Evropian, duke nxitur një treg konkurrues dhe transparent të energjisë, duke adresuar risqet nga varfëria energjetike dhe aspektet mjedisore, si dhe duke rritur përpjekjet e mëtejshme të tranzicionit të gjelbër.

Masat që përfshihen nën këtë objektiv konsistojnë në: (i) rregullimin gradual të tarifave ndaj çmimeve të tregut, të shoqëruara me masa për adresimin e risqeve nga varfëria energjetike; (ii) nxitje e prodhimit të energjisë së rinovueshme përmes zhvillimit të një plani transparent dhe konkurrues për energjinë e rinovueshme; (iii) zbatimin e Direktivës së Energjisë së Rinovueshme; (iv) mekanizmat lidhur me vendosjen e sistemit të tregëtisë dhe emetimit të karbonit të Bashkimit Evropian; (v) kuadri strategjik për eficiencën e energjisë dhe skema e eficiencës së energjisë për godinat publike.

Objektivi 5: Konsolidimi i Shtetit të së Drejtës

Objektivi i pestë synon të kontribuojë në garantimin e pakthyeshmërisë së reformës në drejtësi dhe të konsolidojë më tej punën për sundimin e ligjit dhe shtetin e së drejtës, nëpërmjet masave që luftojnë krimin e organizuar, parandalojnë dhe ulin incidencën e korrupsionit, rrisin efikasitetin e gjyqësorit dhe promovojnë transparencën dhe lirinë e shprehjes, në përputhje me standardet evropiane. Kjo kontribuon në konsolidimin e rezultateve të Reformës së sistemit të drejtësisë dhe pakthyeshmërinë e saj, progresin e vazhdueshëm me efikasitet të sistemit të drejtësisë dhe në përmbushjen e standardeve dhe kritereve të anëtarësimit në BE, si vlerë kyçe e Bashkimit Evropian dhe qeverisjes publike dhe shoqërisë shqiptare.

Masat që përfshihen nën këtë objektiv konsistojnë në: (i) fuqizimin e punës për parandalimin e korrupsionit dhe luftën ndaj krimin të organizuar; (ii) forcimin e kapacitetit institucional dhe kuadrit strategjik në fushën e parandalimit dhe luftës kundër drogave; (iii) konsolidimin e një kornize strategjike dhe veprimi të besueshme dhe të qëndrueshme për të

⁸ NIS - Network and Information Security Directive, EU

parandaluar dhe luftuar pastrimin e parave; (iv) konsolidimin i pavarësisë dhe llogaridhënies së sistemit të drejtësisë nëpërmjet transparencës; (v) rritjen e efikasitetit të sistemit të drejtësisë në të gjitha nivelet; (vi) konsolidimin e progresit për lirinë e shprehjes, në përputhje me standardet evropiane.

1.3.1.1 Dialog dhe bashkëbërje me institucionet e pavarura

Për përgatitjen e Agjendës Kombëtare të Reformave 2024-2027 janë kryer diskutime dhe një proces koordinimi i gjerë ndërinstitucional edhe me institucionet e pavarura, si Kuvendi, Inspektorati i Lartë i Drejtësisë (KLGJ), Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), PPQ, SPAK, ILDKP, Prokurori i Përgjithshëm, Komisioneri për të Dhënat Personale, AMA, etj. Këto institucione kanë qenë pjesë e disa grupeve pune, si (i) grupi i punës për sundimin e ligjit/Themeloret, i koordinuar nga negociatori i kapitullit 23 (Zëvendësministri i Drejtësisë) dhe Ministria e Drejtësisë; (ii) grupi i punës ndërinstitucional për pastrimin e parave, i organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit të Parave; (iii) grupi i punës për krimin e organizuar, i kryesuar nga negociatori i Kapitullit 24 (Zëvendësministri i Brendshëm). Kjo qasje bashkëpunuese dhe ndërvepruese ka synuar përfshirjen e institucioneve të pavarura në diskutimin, dhënien e mendimeve dhe formulimin e reformave, masave, nënmasave, afatet kohore të reformave përkatëse etj. Përfshirja e institucioneve të pavarura në një proces bashkëbërjeje ka qenë shumë e dobishme për arritjen e konsensusit dhe cilësisë së planifikimit për politikën dhe masat e AKR 2024-2027, etj. Në takimet e organizuara nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministri i Shtetit për Antikorrupsionin, si edhe Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit të Parave etj, është shqyrtuar çdo aspekt i reformave në Shtyllën e Sundimit të Ligjit/Themeloret, duke ofruar njohuri dhe rekomandime të vryera për të rritur efektivitetin, zbatueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e reformave, si edhe vetëdijesimin mbi rëndësinë e tyre kombëtare, por edhe në kontekstin e negociatave dhe integritit në Bashkimin Evropian.

1.3.1.3 Konsultimet me aktorët e jashtëm (grupet e interesit, shoqëria civile, publiku)

Dokumenti i politikës AKR 2024-2027 dhe masat për Klimën e Biznesit (Shtylla 1) janë diskutuar në tre (3) takime të organizuara në Nënkomitetin për Integrimin Evropian të Këshillit Ekonomik Kombëtar, ku takimi më i fundit është ai i datës 22.07.2024 të Nënkomitetit për Integrimin Evropian të KEK.

Konsultimet me grupet e interesit dhe Shoqërinë Civile janë organizuar edhe në muajt mars-prill 2024 për të diskutuar mbi shtyllat/masat e Agjendës Kombëtare të Reformave. Janë organizuar pesë takime të Platformave të Partneritetit të Integritit Evropian, si dialog i drejtuar nga negociatorët përkatës sipas kapitujve, të fokusuara në konsultimin e reformave në shtyllat përkatëse prioritare të dokumentit të politikës AKR 2024-2027.

Takimet u kryesuan nga negociatorët /zëvendësministrat e ministrive që udhëheqin reformat në fushat përkatëse, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të partnerëve socialë, organizatave të shoqërisë civile, Think Tanks, OJQ-ve, akademisë etj. Këto sesione ishin pjesë përbërëse e diskutimit dhe për formulimin e masave të Agjendës Kombëtare të Reformave, si dhe sigurimin e një terreni të mirë për mbështetjen e zbatimit të këtyre masave, në rrugën drejt anëtarësimit të vendit në Bashkimin Evropian. Bazuar në ligjin Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", projektvendimi është publikuar dhe në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, më datë 14.06.2024. Konsultimi është mbyllur në datën 12.07.2024. Gjatë periudhës së konsultimit, Dokumenti i Politikës AKR 2024-2027 ka patur 1099 shikime dhe janë paraqitur rreth 72 komente nga këto subjekte: Instituti për

Bashkëpunim dhe Zhvillim (CDI) ka paraqitur 5 komente; nga Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UNWomen) janë paraqitur 17 komente; nga Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë (OSBE) janë paraqitur 8 komente; nga Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) janë paraqitur 28 komente, nga Partnerët për Zhvillim (Partners Albania) janë paraqitur 8 komente dhe Qendra Jonathan janë paraqitur 6 komente.

1.4.2 Zhvillimet kryesore politike dhe angazhimet në mbështetje të procesit të integritimit në BE

Një nga zhvillimet politike më të rëndësishme gjatë kësaj kohe ishte mbajtja e zgjedhjeve për Parlamentin Evropian, më 6-9 qershor 2024. Këto zgjedhje rezultuan me një rritje të së djathtës evropiane, megjithëse qendra politike vazhdon të jetë ende e fortë.

Periodha e raportimit përkon me gjysmën e dytë të mandatit të Presidencës Belge të Këshillit të Bashkimit Evropian. Fokusi i Presidencës Belge për zgjerimin ishte kryesisht në hapjen e negociatave të anëtarësimit me Ukrainën dhe Moldavinë, ndërkohë që u organizua edhe një Konferencë Ndërqeveritare me Malin e Zi, më 25 qershor, 2024 për vlerësimin e piketave të ndërmjetme për kapitujt e sundimit të ligjit.

Gjatë kësaj periudhe raportimi, në lidhje me vlerësimin nga Këshilli të Raporti të Komisionit për Vlerësimin e Piketave hapëse të Grupimit të Kapitujve Themelorë, deri në fund të Qershor 2024, 25 shtete anëtare dorëzuan pëlqimin e tyre me shkrim për Presidencën Belge. (Greqia dhe Qiproja mungojnë).

Gjatë kësaj periudhe raportimi, në lidhje me Shqipërinë Këshilli ka kryer diskutime mbi Raportin e Komisionit Evropian për shqyrtimin analitik (screening) për Grupimin e dytë të kapitujve në 'Tregu i Brendshëm' (9 kapituj). Raporti i shqyrtimit analitik (*screening*) për Grupimin e dytë të kapitujve të 'Tregut të Brendshëm' i Komisionit Evropian u dorëzua gjithashtu në Këshill në fund të majit 2024 dhe ka nisur diskutimi më tej nga vendet anëtare.

Në një vështrim rajonal, Presidenca Belge arriti të sigurojë mbështetjen për miratimin e rregullores së Planit të Ri të Rritjes për Ballkanin Perëndimor, në prill 2024. Parlamenti Evropian dhe Këshilli miratuan më 14 Maj, 2024 rregulloren përkatëse, duke mundësuar nisjen e zbatimit të Shtyllës 3&4 të Planit të Rritjes dhe ofrimin e një mundësie për të aktivizuar grantin prej 2 miliardë EUR plus një huaje prej 4 miliardë EUR për vendet e Ballkanit Perëndimor, bazuar në agjenda kombëtare e reformave, të dakordësuara me BE, Komisionit Evropian nga qeveritë përkatëse. Shqipëria hartoi draft Agjendën e saj Kombëtare të Reformave 2024 - 2027, gjatë periudhës së raportimit dhe vazhdoi të mbështesë aktivisht bashkëpunimin rajonal për zbatimin e Planit të Rritjes të Bashkimit Evropian.

Kryeministri Edi Rama mori pjesë më 15 dhe 16 maj 2024 në Samitin e Liderëve të Ballkanit Perëndimor, dhe Bashkimit Evropian, i cili u mbajt në Kotor, Mali i Zi, me fokus Planin e Rritjes së Ballkanit Perëndimor. Ky takim rajonal u zhvillua nën logon "*Një rajon, vizion i përbashkët*", pason takimet e mëparshme të këtij niveli mes liderëve, në Tiranë dhe në Shkup, ku është diskutuar gjerësisht mbi Planin, që synon rritjen ekonomike të rajonit, përsheptimin e reformave, dhe kryerjen e investimeve, që mund të shpejtojnë procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian me vendet e Ballkanit Perëndimor. Samiti u konceptua në dy panele, përkatësisht: "Angazhimi dhe planet e së ardhmes", si dhe "Kontributi për fuqizimin e bashkëpunimit rajonal", me pjesëmarrjen liderëve të rajonit, si dhe Komisionerit të BE për Zgjerimin dhe Fqinjësinë, Oliver Varhelyi. dhe Ndihmës Sekretarit të Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, James O'Brien. Në Samit ishin të pranishëm drejtues e përfaqësues të

organizatave partnere si Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Banka Evropiane e Investimeve, Banka Botërore, përfaqësues të lartë të Komisionit Evropian, etj.

Më 30 prill 2024, Presidenca Belge ftoi përfaqësuesit e vendeve kandidate në mbledhjen joformale të Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme, në Bruksel, për të përkujtuar 20-vjetorin e zgjerimit të madh të Bashkimit Evropian të vitit 2004. Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, z. Igli Hasani, gjatë pjesëmarrjes në takim, vuri në dukje vendosmërinë e Shqipërisë për të avancuar në procesin e integritimit evropian, si edhe punën dhe hapat e ndërmarrë në drejtim të zbatimit të reformave të lidhura me procesin e anëtarësimit, forcimit të institucioneve dhe sundimit të ligjit.

Më 24 qershor 2024, Përfaqësuesi i Lartë dhe Nënkryetari Josep Borrell ftoi ministrat e jashtëm të Ballkanit Perëndimor në mbledhjen e Këshillit të Punëve të Jashtme në Luksemburg, ku Ministri Hasani nënvizoi mbështetjen e palëkundur të Shqipërisë për objektivat e politikës së jashtme të BE-së, vendimet në kuadër të CFSP dhe në kuadër të misionëve CSDP dhe rëndësinë e unitetit midis Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor. Ministri bëri thirrje për përparim në rrugën e anëtarësimit të vendeve të rajonit në Bashkimin Evropian.

Më 17 dhe 18 prill 2024, Enrico Letta, ish-kryeministri italian dhe tani drejtues i Institutit Jacques Delors, prezantoi raportin e tij mbi zhvillimin e tregut të vetëm në takimin special të Këshillit Evropian. Raporti konsideron ciklin e ardhshëm institucional si kyç për zbatimin e tranzicionit të gjelbër dhe dixhital, përkrah zgjerimit dhe forcimit të sigurisë së Bashkimit Evropian. Gjetjet e raportit dhe politikat e ardhshme bazuar në këto gjetje do të rekomandojnë edhe të ardhmen e tregut të vetëm që Shqipëria synon t'i bashkohet në të ardhmen.

Linjëzimi me deklaratat e Përfaqësuesit të Lartë në emër të 27 vendeve anëtare dhe me vendimet kufizuese të Këshillit të BE ka vijuar në masën 100%.

Më datë 12 qershor 2024, Banka e Shqipërisë, dërgoi aplikimin zyrtar të Republikës së Shqipërisë për anëtarësimin në zonën e vetme të pagesave në euro (SEPA). Kjo është një ditë e mirë jo vetëm për sistemin financiar në vend, por për të gjithë qytetarët shqiptarë. SEPA është një iniciativë e hershme e Bashkimit Evropian për harmonizimin e sistemeve elektronike në Euro, ndërmjet vendeve anëtare. Skemat e Pagesave SEPA i sigurojnë qytetarëve dhe bizneseve evropiane, pagesa ndërkufitare në monedhën e përbashkët, me të njëjtën kosto dhe lehtësi si pagesat brenda vendit të tyre. Megjithatë, zona gjeografike SEPA shtrihet edhe jashtë vendeve të Bashkimit Evropian, duke numëruar deri tani 36 vende që kanë harmonizuar standardet për pagesat elektronike në euro.

- Banka e Shqipërisë ka nisur punën për anëtarësimin e Shqipërisë në SEPA që në vitin 2021, kur u bë pjesë e projektit rajonal "Për modernizimin e sistemeve të pagesave në vendet e Ballkanit Perëndimor". Ky projekt e ka origjinën nga marrëveshjet e Procesit të Berlinit dhe synon zhvillimin e marrëdhënieve financiare dhe ekonomike midis vendeve të Ballkanit Perëndimor, si dhe njëkohësisht integrimin e rajonit në Bashkimin Evropian.

Në nëntor të vitit 2023, Komisioni Evropian shpalli Planin e Ri për Rritjen e Ballkanit Perëndimor, ku një nga prioritetet është pikërisht pjesëmarrja e vendeve të rajonit në SEPA.

Në këtë mënyrë, Komisioni Evropian i dha mundësinë rajonit të përshpejtojë integrimin ekonomik në tregun unik evropian edhe përpara anëtarësimit të tij në Bashkimin Evropian.

Shqipëria është, kështu, vendi i parë në rajon, i cili dërgon aplikimin formal për t'u pranuar në zonën gjeografike SEPA. Pjesëmarrja e Shqipërisë në SEPA, jo vetëm që shënon një hap mjaft të rëndësishëm në rrugëtimin e integritit evropian të vendit, por do të krijojë lehtësira për bizneset dhe konsumatorët shqiptarë në terma të kostos, kohës dhe thjeshtësisë me të cilën do të kryejnë transaksione ndërkufitare brenda tregut evropian.

BE-ja është partneri tregtar kryesor i Shqipërisë, ku rreth 2/3 e tregtisë kryhen me këto vende, ndaj përfitimet nga krijimi i lehtësirave financiare është domethënës për zgjerimin e shkëmbimeve tregtare. Gjithashtu, pjesëmarrja në SEPA i ofron bizneseve shqiptare qasjen në tregun evropian prej 350 milionë banorësh, duke i ofruar mundësi për zgjerimin e aktivitetit të tyre, rritjen e konkurrencës dhe përfitimin e risive.

Pjesëmarrja në SEPA vlerësohet se do të ketë një kontribut domethënës në sektorë strategjikë siç është turizmi dhe në rritjen flukseve të lidhura me investimet e huaja direkte. Ulja e kostove të transfertave në Euro pritet të ndikojë dhe në formalizimin e flukseve të remitancave. Projektionet janë që në afat të mesëm, ekonomia shqiptare do të përfitojë disa qindra milionë Euro nga aderimi në SEPA. Nga pikëpamja e stabilitetit financiar, pjesëmarrja në SEPA ofron një mënyrë për të adoptuar sisteme më moderne, më të sigurta dhe më eficiente të pagesave elektronike. Duke prezantuar alternativa të tilla për qytetarët tanë, synojmë të rrisim përdorimin e pagesave elektronike, uljen e përdorimit të cash-it dhe rritjen e përfshirjes financiare.

Banka e Shqipërisë ka udhëhequr procesin e aplikimit dhe e ka dorëzuar atë në Këshillin Evropian të Pagesave, në emër të komunitetit financiar shqiptar dhe institucioneve publike shqiptare të Republikës së Shqipërisë. Dokumenti i aplikimit është kontribut i disa autoriteteve të tjera publike si: Ministria e Financave, Agjencia e Inteligjencës Financiare, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Autoriteti i Konkurrencës, Ministria e Drejtësisë dhe institucione të tjera shtetërore.

Vlen të theksohet se legjislacioni shqiptar, bazuar në punën e vazhdueshme disavjeçare drejt integritit evropian, përmbush në mënyrë të kënaqshme kriteret për anëtarësimin e Shqipërisë në zonën gjeografike SEPA.

Procesi i aplikimit në SEPA ka pasur mbështetjen dhe asistencën teknike të vazhdueshme të Bankës Botërore, i cili është një partner afatgjatë dhe i rëndësishëm i Bankës së Shqipërisë në fushën e sistemeve të pagesave. Kontributi dhe mbështetja ndër vite e Bankës Botërore ka krijuar bazat e shëndosha që Shqipëria të jetë pararojë në këtë proces.

Shqipëria mbetet në pritje të shqyrtimit të aplikimit zyrtar nga EPC dhe mbështetjes nga Komisioni Evropian.

1.4.3 Dialogu politik në kuadër të negociatave dhe procesit të integritit evropian

Kryeministri z. Edi Rama, ka zhvilluar një sërë takimesh të rëndësishme gjatë periudhës prill-qershor 2024, si më poshtë vijon:

12 prill 2024 - Kryeministri Edi Rama zhvilloi një vizitë zyrtare në Francë, ku u takua me

Presidentin e vendit, Emmanuel Macron. Ndër të tjera, Kryeministri Rama i shprehu Presidentit Macron mirënjohjen për vizionin dhe vendosmërinë me të cilin ka nxitur afrimin ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Evropian, duke vënë në tryezë nevojën për ta shoqëruar këtë proces integrimi me një proces përafrimi përtej rrugëve burokratike. “Ne jemi dëshmitarë të rezultateve për Shqipërinë. Plani i Rritjes që u miratua nga Parlamenti Evropian shkon në këtë drejtim. Një Europë e fortë, e bashkuar që nuk mbetet peng e metodave të vjetra tradicionale. Sot jemi në një situatë krejt të ndryshme”, theksoi Kryeministri Rama gjatë konferencës së përbashkët me Presidentin Francez.

8 maj 2024 - Kryeministri Edi Rama zhvilloi një vizitë pune në Gjermani me rastin e pjesëmarrjes në “Charlemagne Europa Forum”. I ftuar në panelin e diskutimeve me temë “Perspektiva Europiane e Ballkanit Perëndimor”, Kryeministri Rama u shpreh se të qenit pjesë e BE-së është pjesë e një bashkësie paqeje, bashkëpunimi dhe sigurie. “BE-ja për ne nuk ka të bëjë me paratë, por ka të bëjë me një parametër paqeje mbështetur në vlera, një parametër tolerance mbështetur në vlera, një parametër sigurie mbështetur në vlera”, theksoi Kryeministri z. Rama, duke shtuar se Ballkani Perëndimor është aty për t’u bërë dëshmitar i nevojës për të përplotësuar projektin e Bashkimit Evropian.

16 maj 2024 - Kryeministri Edi Rama mori pjesë në Samitin e Liderëve të Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Evropian, i cili u mbajt në Kotor, Mali i Zi, me fokus Planin e Rritjes së Ballkanit Perëndimor. Takimi rajonal u zhvillua nën logon “Një rajon, një vizion i përbashkët”, dhe pasonte takimet e mëparshme të këtij niveli mes liderëve, në Shkup dhe në Tiranë. Në Samit u diskutua gjerësisht mbi Planin e Rritjes për Ballkanin Perëndimor që synon rritjen ekonomike të rajonit, përshpejtimin e reformave kryesore, dhe kryerjen e investimeve që mund të avancojnë procesin e konvergencës të vendeve të rajonit me Bashkimin Evropian.

17 maj 2024 – Kryeministri Edi Rama mori pjesë në takimin e liderëve në kuadër të formatit “Belgrade Security Conference”, që u zhvillua në Tiranë. Ky takim i tretë i një serie eventesh organizuar nga Qendra e Beogradit për Politikën e Sigurisë, titullohej: “Shqipëri dhe Ballkani Perëndimor në Bashkimin Evropian deri në 2030: përballimi i pengesave përpara”. Në ndërhyrjen e tij, Kryeministri Rama shprehu optimizëm për perspektivën e Shqipërisë në Bashkimin Evropian deri në vitin 2030, duke theksuar sfidat aktuale demokratike, por edhe një hapje në rritje ndaj politikës së zgjerimit brenda Bashkimit Evropian. Ai theksoi rëndësinë e fokusimit tek e ardhmja për të ndërtuar një rrugë të suksesshme përpara.

5 qershor 2024 - Kryeministri Edi Rama mikëpriti Kryeministren e Italisë Giorgia Meloni, me të cilën vizituan strukturat pritëse të migrantëve të ngritura në zonën e Shëngjinit, në Lezhë. Gjatë konferencës së përbashkët për shtyp, Kryeministri Rama falënderoi Kryeministren Meloni për vullnetin e mirë që ka treguar për të gjithë rrugëtimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, duke vënë gjithashtu në dukje se Italia është avokati më i rëndësishëm i Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Në këtë kuadër, janë zhvilluar një sërë takimesh të rëndësishme nga ministri i Evropës dhe Punëve të Jashtme gjatë periudhës prill–qershor 2024, si më poshtë vijon:

23 prill 2024 - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Z. Igli Hasani, zhvilloi një vizitë zyrtare një ditore në Kroaci. Gjatë qëndrimit në Zagreb, Ministri Hasani u prit në takim nga Presidenti i Kroacisë, Z.Zoran Milanović, Kryeministri, Z.Andrej Plenković dhe nga homologu i tij, Z.Gordan Grlić-Radman. Gjatë takimeve, Ministri Hasani shprehu, ndër të tjera,

mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme që Kroacia i ka dhënë Shqipërisë drejt rrugëtimit evropian, duke theksuar se ka vetëm një të ardhme për Shqipërinë, anëtarësimi në Bashkimin Evropian.

27 prill 2024 - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Z.Igli Hasani mirëpriti në Tiranë zv. Kryeministren për Integrimin Evropian të Republikës së Moldavisë, Znj.Cristina Gherasimov. Bashkëbiseduesit diskutuan, ndër të tjera, mbi mënyrat praktike për intensifikimin e dialogut politik në rrugën e përbashkët të integritit në Bashkimin Evropian. “Për Shqipërinë dhe Moldavinë ka vetëm një të ardhme, anëtarësimi në BE. Së bashku ne do të vazhdojmë të kryejmë reformat dhe do të bëjmë maksimumin që të dy vendet tona të jenë pjesë e Bashkimit Evropian”, u shpreh ndër të tjera Ministri Hasani.

30 prill 2024 - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Z.Igli Hasani mori pjesë në një takim të nivelit të lartë në kuadër të formatit të Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme të Bashkimit Evropian, organizuar për herë të parë nga Presidenca belge e Këshillit të BE-së, me fokus sundimin e ligjit, në kuadër të procesit të zgjerimit. Ministri rikonfirmoi angazhimin e palëkundur të Shqipërisë për forcimin e shtetit të së drejtës dhe avancimin e agjendës së integritit evropian, teksa theksoi se zgjerimi ka rezultuar gjithmonë dhe përtej çdo dyshimi si një nga politikat më të suksesshme të Bashkimit Evropian dhe tani konsiderohet me rëndësi strategjike, jo vetëm për BE-në, por për të gjithë Ballkanin Perëndimor.

9 maj 2024 - Në Ditën e Evropës, Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Z. Igli Hasani theksoi se procesi i integritit duhet të përshpejtohet drejt anëtarësimit me të drejta të plota në Bashkimin Evropian. Në panelin e diskutimit të organizuar nga MEPJ, e ku mori pjesë edhe Ministrja e Shtetit/Kryenegociatorja, Znj. Dhuka, si edhe përfaqësues të trupit diplomatik të akredituar në Tiranë, Ministri Hasani tha se përshpejtimi i integritit në BE, e bën familjen evropiane më të plotë e të sigurt përkundrejt çfarëdolloj sfide, brenda dhe jashtë kontinentit.

13 maj 2024 - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Z.Igli Hasani, priti në një takim të Dërguarin e Posaçëm të Francës për Ballkanin Perëndimor, Z.Rene Troccaz. Diskutimet u fokusuan, ndër të tjera, edhe tek rëndësia e përpjekjeve bashkëpunuese për të nxitur sigurinë dhe stabilitetin e Ballkanit Perëndimor. Ministri Hasani shprehu mirënjohjen për kontributin e çmuar të Francës në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë dhe Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian, përfshirë ekspertizën dhe burimet e përkushtuara në forcimin e institucioneve dhe përafrimine politikave me standardet e BE-së.

15 maj 2024 - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Z.Igli Hasani priti në takim Ministrin e Shtetit për Çështjet Evropiane dhe Ndërkombëtare të Bavarisë, Z.Eric Beißenger. Në fokus të bisedës ishte bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe Gjermanisë dhe në veçanti ai me Bavarinë, ndërkohë që Ministri Hasani vlerësoi, ndër të tjera, angazhimin e palëkundur të Republikës Federale Gjermane dhe mbështetjen e autoriteteve bavareze në rrugën e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

18 maj 2024 - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Z. Igli Hasani udhëtoi drejt Estonisë, për të marrë pjesë në konferencën ndërkombëtare “Lennart Meri” që u mbajt në kryeqytetin, Talin. Gjatë qëndrimit atje, Ministri Hasani u prit nga Kryeministrja Kaja Kallas, homologu estonez Margus Tsahkna dhe nga drejtues të Komitetit për Politikën e Jashtme në Parlamentin e Estonisë, të cilëve iu shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme të Estonisë ndaj procesit të integritit të Shqipërisë dhe Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian.

3 qershor 2024 - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Z. Igli Hasani dhe Rektorja e Kolegjit të Evropës, Znj. Federica Mogherini, mirëpritën nëpunësit e rinj të administratës publike nga vendet e Ballkanit Perëndimor në trajnimin e parë që hapi dyert e Kolegjit të Evropës në Tiranë, me fokus integrimin evropian dhe bashkëpunimin rajonal. Duke shprehur mirënjohje ndaj qeverisë shqiptare për hapjen në kohë rekord të Kolegjit të Evropës në Tiranë, Ministri Hasani theksoi se Kampusi i Tiranës do ta vendosë rajonin tonë në hartën e profesionistëve të Bashkimit Evropian. Rektorja Mogherini theksoi se nisma të tilla forcojnë bashkëpunimin mes rajonit dhe sjellin më afër integrimin e Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian.

4 qershor 2024 - Në ditën e parë të vizitës së tij zyrtare në Rumani, Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Z. Igli Hasani, zhvilloi një takim me Presidentin Klaus Iohannis, Në fokus të diskutimeve ishte edhe rrugëtimi i Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian. Ministri Hasani vlerësoi mbështetjen e Rumanisë në këtë drejtim, duke e cilësuar atë si një partner të rëndësishëm. Në ditën e dytë të vizitës, Ministri Hasani u takua me homologen e tij rumune, Znj. Luminia Odobescu, me të cilën nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi në fushën e trajnimeve diplomatike. Rumania, theksoi ai, do të vazhdojë të jetë një mbështetëse e pazezervë e procesit tonë të integritimit në BE, jo vetëm politikisht, por edhe me ekspertizë teknike, duke përcjellë përvojën rumune. Sipas tij, Plani i Veprimit për Bashkëpunimin për dy vitet e ardhshme parashikon integrimin evropian si një nga fushat më të rëndësishme të bashkëpunimit dypalësh.

11 qershor 2024 - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Z. Igli Hasani zhvilloi një vizitë zyrtare në Suedi, gjatë të cilës u takua me homologun e tij, Z. Tobias Billström. Gjatë takimit u përcoll mesazhi se Suedia dhe Shqipëria ndajnë të njëjtat vlera dhe qëndrime sa i përket zgjerimit të BE, integritimit të Ballkanit Perëndimor dhe bashkëpunimit rajonal, agresionit rus ndaj Ukrainës dhe mbështetjen ndaj kësaj të fundit. Duke u ndalur në situatën e sigurisë në Ballkanin Perëndimor, ministrat Hasani dhe Billström, nënvizuan nevojën që NATO dhe Bashkimi Evropian të mbajnë fokusin në rajon, të parandalojnë ndikimin e aktorëve të tretë dhe përballjen me dizinformimin dhe sulmet hibride. Ndërkohë, Ministri Hasani u prit edhe nga Kryetari i Parlamentit, Z. Andreas Norlen, Ministrja për Çështje të Bashkimit Evropian, Znj. Jessica Roswall dhe grupi parlamentar i miqësisë për Ballkanin Perëndimor.

12 qershor 2024 - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Z. Igli Hasani, zhvilloi një vizitë zyrtare në Finlandë, ku u prit nga zyrtarë të lartë të vendit. Në takimin e zhvilluar me Ministren për Punët e Jashtme të Finlandës, Znj. Elina Valtonen u diskutua ndër të tjera lidhur me zgjerimin e Bashkimit Evropian, bashkëpunimi në Ballkanin Perëndimor dhe sigurinë globale etj. Ministri Hasani vlerësoi mbështetjen e Finlandës në rrugëtimin e Shqipërisë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, teksa ritheksoi se Shqipëria i ka plotësuar të gjitha kushtet për mbajtjen e Konferencës së dytë Ndërqeveritare me Bashkimin Evropian .

13 qershor 2024 - Shqipëria u bë zyrtarisht shteti i 36-të anëtar i Qendrës Evropiane të Ekselencës Kundër Kërcënimeve Hibride (Hybrid CoE) në Helsinki. Gjatë ditës së dytë të qëndrimit në Finlandë, Ministri Hasani firmosi Memorandumin e Mirëkuptimit, ndërsa e cilësoi anëtarësimin e Shqipërisë si një hap të rëndësishëm në angazhimin e vendit tonë për sigurinë e përbashkët me aleatët e NATO-s dhe vendet anëtare të BE-së. Gjatë qëndrimit në Helsinki, Ministri Hasani pati edhe një bashkëbisedim me Grupin e Miqësisë për Shqipërinë në Parlamentin finlandez, ku theksoi se Shqipëria është mirënjohëse ndaj Finlandës për mbështetjen e fortë të politikës së zgjerimit të Bashkimit Evropian dhe integrimin në Bashkimin

Evropian të Ballkanit Perëndimor. MEPJ Igli Hasani mbajti gjithashtu një fjalë gjatë vizitës së tij në Shoqatën Paasikivi, mbi rolin jetik të integritit evropian për stabilitetin dhe prosperitetin e Ballkanit Perëndimor.

18 qershor 2024 - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Z. Igli Hasani, mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare për Paqen dhe Rritjen e Qëndrueshme, që u mbajt në Athinë. Në këtë event, Ministri Hasani theksoi se integrimi i Shqipërisë dhe rajonit ka mbetur në stanjacion prej vitesh, teksa nënvizoi se qasja, ritmi dhe angazhimi i Bashkimit Evropian për këtë proces duhet të ndryshojë. Sipas tij, anëtarësimi në Bashkimin Evropian për Shqipërinë dhe Ballkanin Perëndimor është thelbësor për stabilitetin, sigurinë dhe paqen e rajonit dhe Evropës në tërësi, ndërkohë që procesi integruues duhet të jetë efikas dhe i besueshëm dhe se çdo gjë më pak do të thoshte kthim pas në kohë dhe përpjekje.

21 qershor 2024 Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Z. Igli Hasani, mori pjesë në konferencën e Grupit të Miqve të Ballkanit Perëndimor me MPJ-të e vendeve të Ballkanit Perëndimor, organizuar në Austri në datat 20 dhe 21 qershor 2024. Ministri Hasani nënvizoi se Bashkimi Evropian duhet të mbajë një afat kohor realist dhe të përkushtuar për procesin e anëtarësimit. Sipas tij, është momenti i duhur që gjërat të bëhen reale me një axhendë ambicioze dhe është koha për të provuar në mënyrat më konkrete vendosmërinë e të gjithëve për të ecur përpara. “Shqipëria e ka treguar vendosmërinë e saj për përsheptimin e procesit të integritit, duke treguar progres të vazhdueshëm në ndërmarrjen e reformave. Ne jemi gati të hapim sa më shumë kapituj të mundshëm gjatë këtij viti. Nuk ka kohë për të humbur dhe shpresojmë shumë që pas një muaji të kemi mundësinë të organizojmë konferencën e dytë ndërqeveritare”, ka theksuar ndër të tjera kryediplomati shqiptar Hasani.

24 qershor 2024 - Me ftesë të Përfaqësuesit të Lartë/Zv. Presidentit të Komisionit Evropian, Z. Josep Borrell, Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Z. Igli Hasani mori pjesë në takim informel mes Ministrave të Jashtëm të Bashkimit Evropian dhe Ministrave të Jashtëm të Ballkanit Perëndimor. Ministri Hasani rikonfirmoi përafrimin e plotë të Shqipërisë me politikat e jashtme dhe ato të sigurisë të Bashkimit Evropian, si dhe nënvizoi integritimin gradual në politikën e përbashkët të jashtme, të sigurisë e të mbrojtjes, si një prej mekanizmave të duhur të para anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator gjatë periudhës prill-qershor 2024, ka zhvilluar takimet si më poshtë vijon:

8 Maj 2024 - ministri i Shtetit dhe Kryenegociator, znj. Dhuka zhvilloi një takim me Rektoren e Kolegjit të Evropës, znj. Federica Mogherini, ku fokus ishte procesi i përgatitjeve dhe diskutimi për çeljen e kampusit të Kolegjit të Evropës në Tiranë. Ministrja u shpreh se ky është një hap tepër i rëndësishëm për vendin dhe sidomos për studentët shqiptarë dhe të rajonit. Aktualisht po ecet me ritme të shpejta për sa i përket përgatitjeve të nevojshme për vitin e ri akademik.

9 Maj 2024 - ministri i Shtetit dhe Kryenegociator, znj. Dhuka mori pjesë në aktivitetin ‘Dita e Evropës – “Evropa në shtëpi”, organizuar nga MEPJ. Ministrja Dhuka prezantoi arritjet e deritanishme të Shqipërisë për sa i përket procesit të negociatave të anëtarësimit si dhe foli mbi përpjekjet për finalizimin e Planit të Rritjes dhe për reformat transformuese për vendin. Gjithashtu, Ministrja shprehu mirënjohjen për bashkëpunimin e vazhdueshëm me institucionet e Bashkimit Evropian. Ajo theksoi rëndësinë e shkëmbimeve të vazhdueshme dhe thellimin e mëtejshëm të ndërveprimeve si bazë për ecurinë pozitive në procesin e integritit në përgjithësi.

27 prill 2024 - Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator, znj. Majlinda Dhuka priti në takim

zëvendëskryeministren për Integrimin Evropian të Moldavisë, Znj. Cristina Gherasimov. Ministrja Dhuka uroi znj. Gherasimov mbi ecurinë pozitive të Moldavisë për sa i përket çështjes së negociatave dhe integritit evropian, një rrugëtim të cilën tashmë Shqipëria e njeh mirë. Znj. Gherasimov u shpreh se vendi i saj mbetet i angazhuar për sa i përket përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga procesi ndërkohë që theksoi se eksperiencia dhe praktikrat e mira të Shqipërisë në këtë drejtim do të ishin tepër të vlyera. Ministrja Dhuka paraqiti një panoramë të gjerë të stadiit ku ndodhet vendi ynë dhe siguroi znj. Gherasimov për mbështetjen e vazhdueshme të palës shqiptare për sa i përket transferimit të njohurive dhe ekspertizës.

14 maj 2024 - ministri i Shtetit dhe Kryenegociator, znj. Dhuka priti në takim të dërguarin e posaçëm të Qeverisë Franceze për Ballkanin Perëndimor Z. Rene Troccaz. Z. Troccaz vlerësoi progresin e Shqipërisë me përfundimin e suksesshëm të procesit screening dhe më tej me miratimin e udhërrëfyesve si kusht për përmbushjen e piketave hapëse për grup-kapitullin e parë. Ministrja Dhuka theksoi se po bëhen përpjekje të vazhdueshme për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga procesi, por njëkohësisht puna ka vijuar edhe me Planin e Rritjes dhe Agjendën e Reformave. Në takim u diskutua nënshkrimi i një Marrëveshjeje Mirëkuptimi ndërmjet dy vendeve për fuqizimin e bashkëpunimit në fushën e Integritit Evropian, por edhe përfitim i modelit francez për ngritjen e Këshillit Ekonomik Social etj.

27 maj 2024 - ministri i Shtetit dhe Kryenegociator, znj. Dhuka priti në takim z. Janos Boka – Ministër për Çështjet Evropiane të Hungarisë. Në takim Ministrja Dhuka paraqiti prioritetet e Shqipërisë për sa i përket procesit të negociatave dhe kërkoi mbështetjen e Hungarisë në zhvillimin e Konferencës së dytë ndërqeveritare, gjatë presidencës së saj, korrik-dhjetor 2024. Ministri Boka prezantoi prioritetet e Hungarisë gjatë presidencës së BE dhe shprehu mbështetjen e plotë të Hungarisë në hapjen e negociatave të Shqipërisë për “Themeloret” dhe më tej.

28 maj 2024 - ministri i Shtetit dhe Kryenegociator, znj. Dhuka priti në takim z. Jeremie Pellet - Drejtor i Përgjithshëm i Expertise France. Në fokus të diskutimeve ishte rrugëtimi i Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian. Në takim Ministrja Dhuka shprehu falenderime për mbështetjen e vazhdueshme të Francës për procesin e integritit evropian dhe paraqiti prioritetet e vendit në kuadër të procesit të integritit dhe Agjendës së Reformave, të hartuar në kuadër të Planit të Rritjes. Z. Pellet garantoi Ministrin Dhuka për mbështetjen e vazhdueshme që Franca dhe ADF/Expertise France do të ofrojnë në vazhdim për Shqipërinë dhe konsolidimin e bashkëpunimit.

15 – 16 qershor 2024 - ministri i Shtetit dhe Kryenegociator, znj. Dhuka mori pjesë në Ministerialin e BE-Ballkani Perëndimor, i cili u zhvillua në Kotor, Mali i Zi. Diskutimi u përqendrua në Planin e Rritjes për Ballkanin Perëndimor, me qëllim shqyrtimin e prioritetëve të dakordësuar për sa i përket integritit në Zonën e Pagesave në Euro (SEPA), avancimin e tregtisë dhe lehtësimin e transportit përmes Korridoreve të Gjelbra, iniciativën WiFi4WB dhe krijimin e Qendrave të Inovacionit Dixhital. Gjithashtu, në takim u diskutua mbi propozimin për ngritjen e një Akademie për Tregun e Përbashkët, integrimin e vendeve të BP në EU Digital Wallet për identifikim të sigurt dhe Aleancën Barnave Kritike. Aktivitetet përfunduan me një prezantim mbi mënyrat e komunikimit të Planit të Rritjes dhe mesazhet kryesore për Samitin e Liderëve.

18 qershor 2024 - ministri i Shtetit dhe Kryenegociator, znj. Dhuka priti në një takim bilateral Ambasadorin z. Niklas Strom. Gjatë takimit, ministri i Shtetit dhe Kryenegociator, znj. Dhuka u shpreh se Shqipëria ka kryer hapa të qenësishme përpara që nga çelja e negociatave të anëtarimit, ku në veçanti përmendi procesin screening, Planin e Rritjes si dhe punën përgatitore për sa i përket etapave të ardhshme. Suedia, si një vend anëtar ka qenë një

mbështetëse e vazhdueshme e procesit të integritit të Shqipërisë. Gjithashtu, Suedia ka ofruar kontribut të vazhdueshëm nëpërmjet bashkëpunimit zhvillimor, duke përfshirë forcimin e institucioneve demokratike, përmirësimin e sundimit të ligjit dhe reformën gjyqësore, si dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore.

21 qershor 2024 - ministri i Shtetit dhe Kryenegociator, znj. Dhuka mori pjesë si pjesë e delegacionit të kryeministrit, në takimin e Këshillit Ekonomik Social Evropian, me vendet e Ballkanit Perëndimor. Nga Presidenti i Këshillit u prezantua nisma pilot për pjesëmarrjen e vendeve candidate në Këshillin Ekonomik Social Evropian. Në takimin e Këshillit, Shqipëria u përfaqësua edhe nga përfaqësues të grupeve të interesit/ shoqërisë civile, që mbajtën dhe një fjalë.

1.5 Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë (MSA) është një marrëveshje kuadër midis Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian (BE), ku përmes dispozitave të veçanta themelojnë struktura të përbashkëta institucionale të stabilizim-asociimit përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të marrëveshjes deri në momentin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Marrëveshja përcakton të drejtat dhe detyrimet reciproke, duke krijuar njëkohësisht mekanizmat e monitorimit të zbatimit të saj dhe bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët, duke synuar përshejtimin e integritit (integritit të përshejtuar) dhe anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Përsa më sipër, gjatë periudhës prill-qershor 2024, në kuadër të MSA-së, vijoi dialogu politik në nivel të lartë ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian.

Në takimet e zhvilluara, përfaqësuesit e Këshillit dhe Komisionit Evropian kanë vlerësuar:

- Zbatimin në tërësi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
- Përparimin lidhur me zhvillimin e një ekonomie tregu me rritje të qëndrueshme;
- Përgatitjen dhe paraqitjen e mirë të Shqipërisë gjatë takimeve bilaterale në kuadër të procesit screening;
- Linjëzimin e plotë të Shqipërisë me qëndrimet dhe deklaratat e politikës së jashtme dhe të sigurisë të Bashkimit Evropian, duke përfshirë qëndrimet e Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit;
- Rolin konstruktiv të Shqipërisë në rajon dhe më gjerë.

1.5.1 Takimet e nënkomiteteve të Stabilizim – Asociimit

Në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, në përputhje me nenin 121 të MSA-së, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2024, në përputhje me kalendarin e MSA 2024, janë zhvilluar takimet e dy nënkomiteteve të Stabilizim-Asociimit:

Takimi i 15-të i Nënkomitetit të Stabilizim-Asociimit “Tregu i brendshëm dhe konkurrenca, duke përfshirë dhe mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit”.

Më datë 30 maj 2024, u zhvillua në Bruksel, takimi i 15-të i Nënkomitetit Bashkimi Evropian – Shqipëri “Tregu i brendshëm dhe konkurrenca, duke përfshirë dhe mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit”. Takimi u fokusua në shqyrtimin e përparimit të bërë nga Shqipëria në këta

kapituj negociues: Kapitulli 3 “E drejta e vendosjes dhe liria e ofrimit të shërbimeve”, Kapitulli 5 “Prokurimi publik”, Kapitulli 6 “E drejta e shoqërive tregtare”, Kapitulli 7 “Pronësia intelektuale”, Kapitulli 8 “Konkurrenca”, Kapitulli 9 “Shërbimet financiare” dhe Kapitulli 28 “Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit”.

Autoritet shqiptare raportuan mbi:

- përafrimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor me acquis e BE-së në fushën e konkurrencës;
- aktivitetin e Autoritetit të Konkurrencës në lidhje me bashkimet, parandalimin dhe ndëshkimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg, marrëveshjet e paligjshme, etj.;
- zhvillimet më të fundit mbi ndihmën shtetërore në lidhje me përafrimin e legjislacionit dhe, kapaciteteve administrative dhe pavarësisë së KNSH-së;
- përafrimin legjislativ me acquis-në në fushën e pronësisë intelektuale dhe industriale, në përputhje me PKIE 2023/24, lidhur me hartimin, konsultimin dhe miratimin e ligjeve të reja në fushën e pronësisë intelektuale dhe industriale, sikurse janë projektligjet e reja “Për patentat”, “Për markat tregtare”, “Për Disenjt”, si dhe projektligji “Për të dretjën e autorit, të cilat priten të miratohen brenda 2024/25, përfshirë miratimin e akteve nënligjore;
- kapacitetet institucionale dhe administrative të Zyrës së të Drejtave të Autorit dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave;
- përafrimin e legjislacionit në lidhje me zbatimin e të drejtave në fushën e PI, duke përfshirë të dhëna për gjobat, sekuestrimin e mallrave të falsifikuara dhe për procedurat gjyqësore;
- funksionimin e organizatave të menaxhimit kolektiv;
- procedurën e licencimit ose rinovimit të licencimit të ZKM-ve, në gusht 2024, nga Drejtoria e së Drejtës së Autorit;
- zhvillimet ligjore dhe harmonizimi me acquis, në fushën e prokurimeve, duke theksuar rëndësinë e përmirësimeve të fundit ligjore dhe përpjekjet për harmonizimin e mëtejshëm me acquis, duke synuar përputhshmërinë me standardet e BE-së;
- përmirësimet në procedurat dhe mjetet e përdorura, duke përfshirë zbatimin e sistemeve të prokurimit elektronik për të thjeshtuar dhe bërë më transparent procesin;
- rritjen e kapaciteteve institucionale dhe administrative për të mbështetur dhe zbatuar në mënyrë të efektshme politikat e prokurimit publik;
- funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik (KPP), duke analizuar rolin dhe efektivitetin e Komisionit në mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave të prokurimit, trajtimin e ankesave dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
- në fushën e lirisë për të ofruar shërbime, ku u raportuan përditësimet në procesin e transpozimit të Direktivës së Shërbimeve;
- përafrimin legjislativ me acquis-në e BE-së në fushës e shërbimeve postare dhe situata aktuale e politikës së re të shërbimeve postare 2021+. Në fokus ishte përafrimi i Direktivës 97/67/KE, e ndryshuar dhe Direktivës 2008/6/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 shkurt 2008, të cilat janë transpozuar në ligjin nr. 46/2015, datë 07.05.2015;
- publikimin në faqen zyrtare të AKEP të tarifave për shërbimet e dërgesës ndërkufitare të parcelave të ofruara nga operatorët;
- përafrimin legjislativ me acquis të BE-së mbi njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale, adresuar nga VKM nr. 823, datë 28.12.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 41, datë 24.01.2018;
- angazhimin e autoriteteve përkatëse për të përditësuar dhe përmirësuar vazhdimisht politikat e mbrojtjes së konsumatorit në nivele të ndryshme (politike, ligjore dhe zbatimi), duke reflektuar si zhvillimet e reja në nivel të BE-së, ashtu edhe nevojat dhe

specifikat e vendit.

- zbatimin e reformave të ndërmarra dhe gjithashtu përafrimin e legjislacionit me acquis të BE-së në fushën e substancave me origjinë njerëzore, produkteve medicinale për përdorim njerëzor, pajisjeve mjekësore, shëndetit mendor, si abuzimit me drogën dhe parandalimin;
- rishikimin e legjislacionit ekzistues në fushën e të drejtës së shoqërive tregtare, duke synuar identifikimin e ndryshimeve ligjore të nevojshme për përafrimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian;
- përmirësimin nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike (POB) si autoritet rregullator i pavarur, të mbikëqyrjes duke u bazuar në vlerësimin e riskut;
- bërjen funksional të regjistrimit të pronarëve përfitues, në përputhje me rekomandimet e Task Forcës së Veprimit Financiar FATF/ICRG;
- rregullimet e mëtejshme ligjore për të përmbushur kërkesat e reja të udhëzimeve më të fundit për procedurat dhe metodologjitë e përbashkëta për procesin e rishikimit dhe vlerësimin mbikëqyrës (SREP) dhe testimin e stresit mbikëqyrës të bankave, SREP (EBA/GL/2022/03);
- zhvillimet legjislative përafrimore deri në vitin 2030, me BRRD I and BRRD II, si dhe hendeqet dhe elementët e mbetur;
- zhvillimet legjislative përafrimore mbi versionin e përditësuar të udhëzimit të SRB-së (single resolution board) për librat e lojës (bail-in playbook) me dorëzani, të bankave, mbi nivelin e mjaftueshëm të përthithjes dhe rikapitalizimit të humbjeve të bankave;
- mashtrimet me mikrokreditë, revokime të licensave, dhe propozime të reja rregullatore të mundshme për të shmangur këtë fenomen;
- zhvillimet mbi acquis në fushën e pagesave si dhe zhvillimet mbi aplikimin në SEPA (brenda qershor, 2024) dhe skemat e SEPA;
- zhvillimet legjislative përafrimore dhe infrastrukturore të regjimit Solvency II, mbi tregun e letrave me vlerë dhe sigurimeve; ekspertët e KE informuan mbi prezantimin e një regjimi rregullator të harmonizuar, të shtuar që do të lancohet së shpejti;
- zhvillimet legjislative, si dhe depozitimin/regjistrimin e letrave me vlerë, mbi punimet e sistemit qëndror të shlyerjes dhe regjistrimit të letrave me vlerë të qeverisë shqiptare, si dhe zhvillimet legjislative për kleringun dhe shlyerjen e llojeve të tjera të letrave me vlerë;
- zhvillimet legjislative përafrimore me “Rregulloren Evropiane të Infrastrukturës së Tregut” (EMIR) për derivatet pa bursë, palët qëndrore, depot e tregtisë, si dhe kërkesat e licencimit të palëve qëndrore dhe shtëpive të klerimit.

Gjatë takimit të Nënkomitetit, përfaqësuesit e Komisionit Evropian dhanë disa rekomandime për t'u ndjekur nga institucionet përgjegjëse shqiptare:

- Në fushën e politikës së konkurrencës: Komisioni mirëpriti planet e autoriteteve shqiptare për të harmonizuar më tej kuadrin ligjor me acquis të BE-së. Vëmendje e veçantë iu kushtua ndihmës shtetërore, ku Komisioni rikujtoi nevojën për të garantuar pavarësinë operationale të Komisionit të Ndihmës Shtetërore dhe zbatimin e kuadrit ligjor.
- Për sa i përket të drejtave të pronësisë intelektuale: Komisioni përgëzoi përparimin e bërë deri tani nga Shqipëria dhe inkurajoi autoritetet që të përfundojnë përafrimin e kuadrit ligjor me pjesët e mbetura të acquis në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të, si dhe të drejtave të pronësisë industriale. Komisioni mirëpriti trajnimet dhe aktivitetet ndërgjegjësuese për të drejtat e pronësisë intelektuale të ndërmarra nga autoritetet, veçanërisht në fushën e zbatimit.

- Për lirinë e ofrimit të shërbimeve, Komisioni theksoi nevojën për të rritur përpjekjet për përafrimin e kuadrit ligjor me Direktivën e Shërbimeve. Për sa i përket shërbimeve postare, ku Shqipëria ka përafruar legjislacionin e saj me acquis të BE-së, diskutimi u fokusua në zbatimin e tij. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për t'u përgatitur për sistemin e njohjes reciproke të kualifikimeve profesionale të BE-së;
- Në fushën e prokurimit publik: Komisioni inkurajoi autoritetet shqiptare të shtojnë përpjekjet për të përafruar kuadrin ligjor me acquis të BE-së, duke përfshirë edhe fushën e koncesioneve.
- Për shërbimet financiare: Komisioni përgëzoi përpjekjet e vazhdueshme për të harmonizuar kuadrin rregullator dhe mbikëqyrës bankar shqiptar me standardet ndërkombëtare dhe të BE-së. Për sa i përket ligjit të kompanive dhe raportimit të korporatave, Komisioni inkurajoi autoritetet që të vazhdojnë procesin e përafrimit të legjislacionit me acquis të BE-së.
- Në fushën e mbrojtjes së shëndetit: Komisioni raportoi mbi përditësimet e fundit në legjislacionin e BE-së në fushën e substancave me origjinë njerëzore të destinuar për përdorim njerëzor. Komisioni i kërkoi Shqipërisë që të bëjë përparim në përafrimin e legjislacionit të saj me acquis të BE-së për kontrollin e duhanit, substancat me origjinë njerëzore, produktet medicinale për përdorim njerëzor dhe veterinar, dhe kujdesin shëndetësor ndërkufitar. Komisioni vuri në dukje planet e autoriteteve për të harmonizuar më tej kuadrin ligjor me acquis të BE-së në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve.

Takimi i 15-të i Nënkomitetit Transporti, Energjia Mjedisi dhe Zhvillimi Rajonal

Më datë 11 qershor 2024 u zhvillua në formatin online takimi i 15-të i Nënkomitetit Transporti, Energjia, Mjedisi dhe Zhvillimi Rajonal. Ky takim u kryesua për palën shqiptare nga Znj. Enkelejda Muça, Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë njëkohësisht Negociator për kapitujt 14, 15, 21 dhe bashkënegociator i kapitullit 10, ndërsa për palën evropiane nga Znj. Simona Gatti, Ekspert i lartë, Koordinator i Politikave të Planit të Investimeve Ekonomike dhe Axhendës së Gjellbër, në Drejtorinë e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit, Njësia D3 Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut.

Në takim u diskutuan çështje që kanë të bëjnë me: Kapitullin 14 – Politika e Transportit, Kapitullin 15 – Energjia, Kapitullin 21 – Rrjetet transevropiane, Kapitullin 27 – Mjedisi dhe ndryshimet klimatike dhe Kapitullin 22 – Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore.

Grupimi i kapitujve të përfshira në këtë nënkomitet dhe reformat në fjalë kanë lidhje të rëndësishme me Programin e Reformave Ekonomike të Shqipërisë, Planin Ekonomik të Investimeve të Komisionit dhe Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor, si dhe Planin e Rritjes së BE-së për Ballkanin Perëndimor.

Në lidhje me rekomandimet e palës evropiane, pala shqiptare shprehu konsideratat për mbështetjen e Komisionit Evropian, si dhe ritheksoi angazhimin serioz të Shqipërisë për të vijuar punën për ndjekjen dhe raportimin e progresit të tyre deri në takimin e radhës së Nënkomitetit në vitin 2025.

Në përgjithësi rekomandimet e Komisionit Evropian u fokusuan në:

- Nevojën për përpjekje të mëtejshme në fushën e energjisë së rinovueshme dhe efikasitetit të energjisë;

- Për mjedisin dhe klimën, nevojiten përpjekje të mëtejshme për menaxhimin e ujit dhe mbetjeve, zbatimin e ligjit mjedisor dhe mbrojtjen e natyrës;
- Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit vazhdon të kërkojë vëmendje të veçantë nga ana e Shqipërisë;
- Strategjia Kombëtare e Transportit dhe Strategjia e re e Sigurisë Rrugore duhet të miratohen sa më parë, në përputhje me Planin e Veprimit për Sigurinë Rrugore të Komunitetit të Transportit;
- Adresimi i çështjeve të ndryshimeve klimatike, duke forcuar politikat e tranzicionit të gjelbër;
- Nevojiten përpjekje të mëtejshme në politikën rajonale, veçanërisht në drejtim të kapaciteteve administrative dhe koordinimit ndërmjet niveleve qendrore dhe vendore, si dhe në dispozitat financiare dhe buxhetore;
- Përafrimi dhe zbatimi i legjislacionit të BE-së si dhe zhvillimi i kapaciteteve adekuate administrative është një proces afatgjatë që nuk mund të vonohet dhe duhet përsheptuar..

1.5.2 Progres lidhur me kontributin e parë të Shqipërisë në kuadër të progres-raportit të Komisionit Evropian të vitit 2024

Në kuadër të hartimit të raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, të vitit 2024, shërbimet e Komisionit kanë kërkuar hartimin dhe dërgimin e dy kontributëve gjatë vitit 2024, ku duhet të përfshihen arritjet e realizuara nga vendi ynë nga 1 shtatori 2023 deri më 1 shtator 2024 (kontributi i parë përfshin periudhën 1 shtator 2023 – 29 mars 2024, dhe kontributi i dytë 30 mars 2024 – 1 shtator 2024).

Bazuar në kërkesën e Komisionerit Evropian për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit dhe listës së pyetjeve të përcjella zyrtarisht, përgjatë periudhës së raportimit, është hartuar nga Sekretariati i Integritetit Evropian dhe institucionet shqiptare, Kontributi i parë i progresit për vitin 2024.

Kontributi i parë, është i organizuar dhe strukturuar mbi bazën e kapitujve negociues në përputhje me metodologjinë e BE-së. Kontributi u përcoll pranë shërbimeve të Komisionit Evropian, në datën 24 prill 2024.

Çështjet kryesore ku është raportuar progres domethënës në Kontributin e parë të vitit 2024, sipas grupimeve të kapitujve, janë si më poshtë:

Grupimi i Kapitujve 1 “Themeloret”

- Reforma në drejtësi ka vijuar me zbatimin e saj, duke miratuar në kohë masat e nevojshme të tranzicionit dhe duke përfunduar në kohë procesin e rivlerësimit të përkohshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve (vetting) në apel, pa cënuar cilësinë e shqyrtimit gjyqësor. Gjithashtu, Shqipëria ka shtuar përpjekjet për të konsoliduar pavarësinë e gjyqësorit dhe për të zvogëluar numrin e çështjeve të prapambetura (backlog-u) në të gjitha nivelet e gjyqësorit.
- Në fushën e punëve të brendshme, janë paraqitur arritje të rëndësishme në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Këto arritje tregojnë angazhimin dhe bashkëpunimin efektiv operacional me agjencitë e Bashkimit Evropian, veçanërisht me Frontex dhe Europol, si dhe me shtetet anëtare të BE-së. Përpjekjet e përbashkëta kanë përfshirë operacione të

përbashkëta, shkëmbim informacioni, trajnime dhe asistencë teknike, duke rezultuar në një numër të konsiderueshëm arrestimesh dhe ndjekje penale të suksesshme. Ky bashkëpunim është një tregues i qartë i përkushtimit për të përmirësuar sigurinë dhe stabilitetin në rajon, duke u përafëruar më shumë me standardet dhe praktikatat e BE-së. Në lidhje me Prokurimin Publik, u shënuan disa zhvillime, që lidhen kryesisht me ndryshimet e kuadrit ligjor që synojnë të përmirësojnë dhe të rregullojnë më tej sistemin e prokurimit publik në vend.

- Është përgatitur nga Grupi Ndërinstitucional i Punës, drafti i Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik 2024-2030 dhe Planit të Veprimit për zbatimin e saj 2024-2027, duke synuar të sigurojë një sistem prokurimi efikas dhe të qëndrueshëm, bazuar në praktikatat më të mira ndërkombëtare.
- Në funshën e statistikave, vlen të theksohet publikimi i rezultateve të "Censit të Popullsisë dhe Banesave" në Qershor 2024. Instituti i Statistikave (INSTAT), ka kontribuar gjithashtu në finalizimin e raportit vjetor për Komisionin Evropian dhe realizimin e "Censit të Bujqësisë dhe Fermave Bujqësore".
- Janë miratuar gjatë 3-mujorit të parë të vitit 2024, ndryshimet VKM nr. 887, datë 27.12.2022 "Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike".
- Politika monetare e BSH-së ka kontribuar në rikthimin e inflacionit në objektivin prej 3%, i cili për shkak të Pandemisë Covid – 19 dhe luftës në Ukrainë ishte mbi këtë prag dhe objektivi i politikës monetare të BSH është mbajtja e inflacionit në nivelin 3%.
- Në fillim të vitit 2024 është miratuar "Strategjia për Edukimin dhe Përfshirjen Financiare 2024-2026".
- Udhërrëfyeni "Reforma e Administratës Publike 2023-2030", është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 737, datë 13.12.2023.
- Është ngritur Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës me qëllim promovimin inovacionin dhe angazhimin në administratën publike, përmes hartimit dhe zbatimit të politikave në bashkëpunim me ministritë përkatëse të linjës në fushat dhe sektorët që lidhen me inovacionin.

Grupimi i Kapitujve 2 "Tregu i Brendshëm"

- Qendra Kombëtare e Biznesit është vlerësuar me certifikatën ISO 9001:2015, e cila është një standard mbarëbotëror që vendos kërkesat për një sistem të fortë të menaxhimit të cilësisë, për "Shërbimet në Regjistrin Tregtar, Regjistrin e Licencave, Autorizimet dhe Lejet dhe Regjistrimi i Pronarëve Përfitues"
- Me qëllim harmonizimit të mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së për gjakun, indet, qelizat dhe organet, u miratua me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 97, datë 23.02.2024 "Rregullorja për sigurimin e cilësisë". Kjo rregullore është në përputhje të plotë me kërkesat e Direktivës së BE-së 2005/62/EC. Gjithashtu, me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 77, datë 13.02.2024 u miratua Plani i Veprimit 2024-2030 "Mjaftueshmëria me gjak të sigurt dhe cilësor".
- Plani i Veprimit për Parandalimin, Trajtimin dhe Reduktimin e Dëmeve të Lidhura me Drogat 2023-2026 është miratuar me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.138, datë 08.03.2024, në përputhje me Strategjinë e BE-së për Drogën 2021-2025 dhe planin e saj të veprimit.
- Shqipëria, në datën 29 Mars, ka dorëzuar Para-Aplikimin për Përfshirjen e Shqipërisë në "Hapësirën Gjeografike" të Zonës së vetme të Pagesave në Euro (SEPA) pranë DG FISMA. Në lidhje me lëvizjen e lirë të kapitaleve, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në kuadër të aplikimit të kuadrit SEPA ka miratuar në datën 3 Prill 2024 Rregulloren "Për përcaktimin e kërkesave për transfertat e kredisë dhe debitimet direkte në euro".

- Lidhur me Lëvizjen e Lirë të Punëtorëve, janë bërë përparime në lidhje me aksesin në tregun e saj të punës për qytetarët e BE-së dhe anëtarët e familjeve të tyre shoqëruese. Punëtorët dixhitalë tani mund të paraqesin një vetëdeklarim në lidhje me një kontratë të vlefshme gjatë fazës fillestare të procesit të aplikimit.
- Është hartuar Strategia e re e Migracionit 2030 së bashku me Planin e Veprimit për periudhën 2024-2026, me qëllim trajtimin e sfidave që gjenerohen nga lëvizjet migratore.
- Është ndërmarrë reformimi i kuadrit ligjor për të drejtën e autorit (copyright) dhe tëpronësisë industriale: Në të drejtën e autorit janë adresuar rregullimet ligjore lidhur me hartimin e akteve nënligjore për menaxhimin kolektiv; në fushën e pronësisë industriale janë hartuar ligje të veçanta për objektet e pronësisë industriale, (markat, patentat, dizenjt, etj.), të cilat janë konsultuar me grupet e interesit dhe priten komentet e shërbimeve të Komisionit.

Grupimi i Kapitujve 3 “Konkurrueshmëria dhe Rritja Gjithëpërfshirëse”

- Projektligji “Për sigurinë kibernetike” u miratua në Kuvend më 21 mars 2024, çka përbën një nga hapat konkret që Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike ka ndërmarrë për të vijuar me nivelin e plotë të harmonizimit me Direktivën (BE) Nr.2022/2555 (NIS 2).
- Është përgatitur projektligji “Për komunikimet elektronike”, i cili u miratua nga Këshilli i Ministrave në 3-mujorin e parë të vitit 2024, dhe kaloi për miratim përfundimtar në Kuvend.
- Me qëllim standardizimin e procedurave në lidhje me veprimtarinë e kontrollit të cilësisë së strukturave të mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor është miratuar Udhëzimi nr. 767, datë 28.12.2023, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, u miratua “Metodologjia e kontrollit të cilësisë së punës së strukturave të mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor”.
- Shqipëria ka ratifikuar ligjin nr.73/2023 “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovakisë për Eliminimin të Tatimit të Dyfishtë në lidhje me Tatimet mbi të Ardhurat dhe Parandalimin dhe Shmangien e Evazionit Tatimor.”
- Është përgatitur Udhërrëfyese S3 sipas Kornizës së JRC-së dhe është finalizuar drafti i strategjisë.
- Shqipëria ka nënshkruar dhe ratifikuar Marrëveshjen e Asociimit me Komisionin Evropian për pjesëmarrje në Programin e Evropës Dixhitale.
- Programi Kombëtar për Zhvillimin Profesional të Mësuesve, i shpallur në fillim të 2024, ka nisur dhe do të zbatohet deri në fund të 2025.

Grupimi i Kapitujve 4 “Agjenda e Gjelbër dhe Lidhshmëria e Qëndrueshme”

- Shqipëria mori presidencën e Komitetit Teknik të Transportit të Mallrave të Rrezikshme, pjesë e Komunitetit të Transportit, i kryesuar nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me Ministrin e Evropës dhe Punëve të Jashtme.
- Nga data 1 shkurt 2024, ankandet e Ditës në Avancë në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike, ALPEX, tashmë zhvillohen si bashkim tregjesh mes Shqipërisë dhe Kosovës. Kjo shënon inaugurimin e tregut të ditës në vazhdim në Kosovë dhe inicon bashkimit të tregut Shqipëri-Kosovë, i pari i këtij lloji në Komunitetin e Energjisë.
- Liberalizimi në tregun e energjisë ka kaluar në një fazë të re, duke filluar nga 2024, bizneset e lidhura në tension 20 kilovolt, tashmë operojnë në tregun e lirë, që do të thotë se duhet ta sigurojnë të vetëm energjinë nga furnizuesit e licencuar.
- Janë miratuar nga Kuvendi rishikimi i ligjit 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, si dhe Ligji i ri nr. 29, datë 04.04.2024, “Për burimet ujore”.

Grupimi i Kapitujve 5 “Burimet, Bujqësia dhe Kohezioni”

- Në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, janë bërë përparime në forcimin e kapaciteteve të Agjencisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Në lidhje me Sistemin e Administratës dhe Kontrollit të Integruar, janë vërejtur përparime në Regjistrin Kombëtar të Fermerëve, i cili tashmë përfshin rreth 132,000 ferma. Ky regjistër, i integruar me sistemin e Agjencisë së Pagesave, lehtëson pagesat direkte online dhe përditësohet vazhdimisht me të dhënat nga fermerët përfitues.
- Në fushën e sigurisë ushqimore, është përparuar në sektorët e veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve me përditësime në stafin, legjislacionin dhe programet e kontrollit të sëmundjeve. Në kuadër të Programeve kryesore të kontrollit të sëmundjeve janë bërë përpjekje aktive mbi mbikqyrjen dhe vaksinimin për sëmundje si Bruceloza, Antraksi, Tuberkulozi, Tërbimi, Influenca e Shpendëve, FMD, Gjuha Blu dhe ASF, me mbështetjen e buxhetit të shtetit.
- Në fushën e peshkimit ka vijuar përafrimin me acquis të BE-së, ku vlen të përmendet: kuadri ligjor që rikonfiguron Drejtorinë e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, për të garantuar rriten e aftësive të kontrollit dhe inspektimit në përputhje me Rregulloren e BE-së 2019/473; gjithashtu, Udhëzimi i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 2/2024 për krijimin e programeve të kontrollit dhe inspektimit për peshkimin, përafron pjesërisht Vendimin e BE-së 2018/1986.

Grupimi i Kapitujve 6 “Marrëdhëniet me Jashtë”

- Shqipëria vazhdon të mbetet 100% e linjësuar me Deklaratat e Përfaqësuesit të Lartë, në emër të BE, si dhe me Vendimet e Këshillit të BE-së për masat kufizuese. Shqipëria zbaton në territorin shqiptar vendimet e Këshillit të BE-së, për masat kufizuese.

Pala shqiptare paraqiti përparimin dhe aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2023 dhe fillimit të vitit 2024 në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe rekomandimeve të Raportit të Komisionit për Shqipërinë për vitin 2023 dhe takimit të këtij Nënkomiteti zhvilluar në vitin 2023 (7 qershor 2023).

Në fushën e *mjedisit dhe ndryshimeve klimatike*, pala shqiptare paraqiti përparimin e bërë duke u fokusuar në:

1. Autoritetet shqiptare, në fushën e *legjislacionit horizontal*, raportuan mbi ndryshimet e bëra në kadrin ligjor të Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor (VSM/VNM);
2. Në fushën e *cilësisë së ujit*, autoritetet shqiptare, raportuan mbi miratimin e “Strategjisë kombëtare të sektorit të ujësjellës kanalizimeve për periudhën 2023 – 2030”;
3. Në fushën e *manaxhimit të mbetjeve*, autoritetet Shqiptare raportuan për zhvillimet më të fundit mbi planet për grumbullimin e mbetjeve, si edhe mbi zbatimin e *acquis* së BE-së, mbi dokumentin e politikave strategjike të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe planin kombëtar 2020-2035, gjithashtu u raportua mbi suksesin në përdorimin e qeseve plastike me parametër 70 micron;
4. Lidhur me *zhurmat* autoritetet shqiptare raportuan mbi monitorimin e zhurmave urbane, në përputhje të plotë me programin kombëtar të monitorimit, monitorim i cili kryhet sipas standardeve të përcaktuara nga OBSH dhe ligjit Shqiptar Nr 9774, datë 12.07.2007;
5. Autoritetet shqiptare përsa i përket *mbrojtjes së natyrës*, raportuan mbi ndryshimet në legjislacionin kombëtar për mbrojtjen e natyrës të miratuara në mars 2024, si dhe

mbi hartimin e planit të integruar të menaxhimit për zonat e mbrojtura të përcaktuara, si parku kombëtar i lumit të egër Vjosa;

6. Përsa i përket fushës së mbrojtjes civile, autoritetet Shqiptare informuan mbi Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Unionit, si edhe mbi miratimin e Planit Kombëtar të Emergjencave Civile;
7. Në fushën e ndryshimeve klimatike, autoritetet shqiptare raportuan mbi zbatimin e Kontributit Kombëtar të Përcaktuar sipas Marrëveshjes së Parisit (NDC) të përditësuar, si edhe mbi bashkëpunimin rajonal në kuadër të Komuniteti të Energjisë.

Në fushën e *mjedisit dhe ndryshimeve klimatike*, pala evropiane rekomandoi që:

1. Mbi legjislacionin horizontal, Komisioni theksoi nevojën për përafrimin e plotë të kuadrit ligjor kombëtar të VNM-së dhe VSM-së me direktivat përkatëse të BE-së.
2. Në fushën e mbrojtjes së natyrës, Komisioni theksoi rëndësinë e vlerësimit paraprak të impaktit të ndërhyrjeve në territor, si dhe ritheksoi nevojën për kufizimin e ndërtimit në zonat natyrore të mbrojtura. Komisioni mirëpriti faktin e ndërprerjes së punimeve mbi lumin Vjosa me shpalljen e kësaj zone Park Kombëtar;
3. Komisioni, vlerësoi progresin e arritur të autoriteteve shqiptare veçanërisht në sektorin e ujit, duke përgëzuar mbi miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Ujësjellës Kanalizimeve për periudhën 2023 – 2030;
4. Gjithashtu, Komisioni, inkurajoi autoritetet shqiptare mbi vijimin e reformave dhe përafrimin e plotë me legjislacionin e BE-së në sektorët e cilësisë së ajrit, menaxhimit të mbetjeve dhe mbrojtjes së natyrës;
5. Përsa i përket kimikateve, Komisioni nënvizoi përparimin e bërë në të gjithë sektorin e kimikateve në tërësi, si edhe përdorimin e mirë të asistencës teknike të ofruar nga agjensia Suedeze KEMI;
6. Në fushën e zhurmave, Komisioni mirëpriti programin e Shqipërisë për monitorimin e zhurmës për vitin 2023, gjithashtu i rikujtoi autoriteteve Shqiptare të jenë plotësisht të përgatitur për të siguruar zbatimin e *acquis* së BE-së. Komisioni theksoi rëndësinë mbi zhvillimin e mëtejshëm mbi hartat dhe planet e veprimit për menaxhimin e zhurmës, si edhe kryerjen e konsultimeve të nevojshme me publikun;
7. Lidhur me mbrojtjen civile, Komisioni përgëzoi Shqipërinë, duke e cilësuar si një shtet pjesëmarrës aktiv, duke bërë maksimumin për të kontribuar në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të BE-së si anëtare me të drejta të plota;
8. Sa i përket ndryshimeve klimatike, Komisioni përgëzoi autoritetet shqiptare mbi progresin e arritur në lidhje me draftin e Kontributeve të përcaktuara në nivel kombëtar (NDC), si edhe miratimin e tetë planeve vendore.

Në lidhje me rekomandimet e palës evropiane mbi çështjet konkrete të mjedisit dhe ndryshimeve klimatike, pala shqiptare shprehu konsideratat për mbështetjen e Komisionit Evropian, si dhe ritheksoi agazhimin serioz të Shqipërisë për të vijuar punën në sektorët e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike, duke vendosur theksin në çështje si cilësia e Ajrit, ku është duke u finalizuar Plani i Veprimit, si dhe duke miratuar ngritjen e Komisionit Kombëtar për Ajrin e Pastër. Gjithashtu, pala shqiptare u shpreh e gadishme për të ratifikuar Protokollin e Goteborgut dhe për të reduktuar emetimet e ndotësve të ajrit.

Në fushën e *transportit*, pala shqiptare paraqiti përparimin e bërë duke u fokusuar në:

1. Strategjinë Kombëtare të Transportit, e cila është draftuar dhe në proces konsultimi, si dhe parashikohet të miratohet në fund të vitit 2024. Gjithashtu, informuan se së bashku

me sekretariatit e TCT-së, ka filluar procesi i hartimit të Strategjisë së re të Transportit dhe Planit të Veprimit 2025 – 2030.

2. Shqipëria raportoi gjithashtu për disa ushtrime pilot për vlerësimin e kostove të përafritit për transpozimin e plotë të direktivave të BE-së, të rekomanduara nga KE dhe të marra si angazhim gjatë takimeve bilaterale. Për këtë, pala shqiptare, kërkoi mbështetjen e Bashkimit Evropian, me asistencë teknike të ndryshme si TAIEX, Sekretariati i TCT etj.
3. Gjithashtu, pala shqiptare raportoi se përfarimi i legjislacionit në fushën e transportit rrugor dhe hekurudhor është duke vazhduar, në bashkëpunim me asistencë e GIZ.
4. Në fushën e transportit detar, Shqipëria raportoi se Porti i Durrësit dhe ai i Porto Romanos, drejtohen tashmë, pas miratimit të disa akteve nënligjore, nga një Autoritet Portual i vetëm (ai i Durrësit), duke zgjeruar në këtë mënyrë fuqinë rregullatore. Kjo është bërë duke ndjekur shembullin e porteve të Evropës Veriore dhe atyre të Mesdheut. Për sa i përket Korridorit VIII, u raportua se, Porto Romano i ka kaluar hapat e të gjitha detyrimeve rregullatore për sa i përket lejeve, sondazheve dhe vlerësimit të ndikimit në mjedis. Qeveria dhe Kuvendi kanë miratuar buxhetin për financimin e objektit të ri në muajin Shkurt të vitit 2024, dhe kanë autorizimin për të vazhduar me shpalljen e procedurës prokurim ndërkombëtar për ndërtimin e tij.
5. Sa i takon makinave elektrike, Shqipëria raportoi se ka aplikuar në kuadër të Programit Operacional për eEnergjinë 2024-2027 (IPAI), ku një nga fushat e mbështetjes është rritja e qarkullimit të automjeteve elektrike me karikim të shpejtë.

Në fushën e *transportit*, pala evropiane rekomandoi që:

1. Për Agjendën e Konektivitetit, Komisioni përgëzoi progresin e bërë në zbatimin e Planit të Veprimit të TCT, si dhe inkurajoi vazhdimin e zbatimit të Planit si dhe të legjislacionit që pëmban Aneksi 1 i tij. Gjithashtu, përgëzoi Shqipërinë mbi hartimin e draft dokumentit të Strategjisë Kombëtare të Transportit dhe Planit të Veprimit.
2. Komisioni informoi se Shqipëria do të jetë pjesë e Korridorit të ri të Ballkanit Perëndimor, Mesdhetar dhe Lindor dhe inkurajuan Shqipërinë të jetë në kontakt të ngushtë me Sekretariatit e TCT, veçanërisht në lidhje me kërkesat dhe përputhshmërinë me standartet e TEN-T.
3. Komisioni kërkoi një qartësim të situatës sa i takon lëvizjes së ngarkesës së mallrave nga Porti i Durrësit në Porto Romano, duke theksuar rëndësinë e njohjes së lidhjes efektive të Porto Romanos me Korridorin VIII.
4. Sa i takon transportit rrugor, Komisioni mirëpriti përafrimin e pjesshëm të Direktivës e cila përcakton për mjete të caktuara rrugore, dimensionet dhe peshat maksimale të autorizuar në trafikun ndërkombëtar.
5. Komisioni inkurajoi Shqipërinë që të zbatojë plotësisht veprimet e përcaktuara në Planin e Veprimit të TCT për Sigurinë Rrugore dhe mirëpriti përpjekjet e vazhdueshme për të finalizuar një strategji të re të sigurisë rrugore.
6. Komisioni vlerësoi punën e bërë nga Shqipëria për Direktivën për krijimin e zonës së vetme hekurudhore evropiane dhe hapjen e tregut për shërbimet hekurudhore. Sa i takon kuadrit institucional hekurudhor, Komisioni mirëpriti ngritjen e Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore dhe Autoritetit Kombëtar të Hetimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore dhe Detare.
7. Në sektorin e transportit detar, pala evropiane theksoi rëndësinë e përsheptimit të masave konkrete për përmirësimin e performancës së anijeve të transportit detar me flamur shqiptar, si dhe kalimi i flotës në listën gri, për të pasur mundësi për të aplikuar për anëtarësim në Memorandumin e Parisit.
8. Për të drejtat e pasagjerëve u vlerësuan angazhimet dhe përpjekjet e bëra nga Shqipëria duke miratuar disa udhëzime në sektorin hekurudhor, rrugor dhe në transportin ajror.

Në lidhje me rekomandimet e palës evropiane mbi çështjet konkrete të transportit, pala shqiptare shprehu konsideratat për mbështetjen e Komisionit Evropian, si dhe ritheksoi agazhimin serioz të Shqipërisë për të vijuar punën për ndjekjen e dhe raportimin e progresit të tyre deri në takimin e radhës së Nënkomitetit në vitin 2025.

Në fushën e *energjisë*, pala shqiptare paraqiti përparimin e bërë duke u fokusuar në:

1. Aktualisht janë dy projektet e interkonjeksionit: i) me Greqinë, i cili aktualisht është në fazën e finalizimit të f termave të referencës; ii) dhe tjetri, me Maqedoninë e Veriut, i cili ka pasur disa ndryshime të kostove për shkak të ndryshimeve të çmimeve. Për këtë është bërë nga NIPAC, në Gusht të 2023 një kërkesë për ngritjen e fondeve të grantit, kërkesë e cila është miratuar nga WBIF. Gjithashtu, raportoi se aktualisht është duke u përgatitur draft VKM e cila lidhet me projektet e reja të interkonjeksionit, e cila do të jetë në përputhje me direktivën e re të BE-së, dhe parashikohet të miratohet në fund të vitit 2025.
2. Në lidhje me miratimin e NECP puna ka vijuar intesivisht për reflektimin e komenteve të sekretariatit të energjisë, dhe miratimi i saj pritët brenda vitit 2024.
3. Shqipëria ka marrë detyrimin për të transpozuar ndryshimet ligjore në paketën e integritit të energjisë elektrike, e cila do jetë në përputhje me kërkesat e Komunitetit të Energjisë. Informoi gjithashtu se po punohet, në bashkëpunim me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, për përmirësimin e legjislacionit, bazuar në paketën e 4-të të energjisë elektrike.
4. Pala shqiptare informoi se pas miratimit të ligjit të ri për energjitë e rinovueshme po vazhdon puna për draftimin e akteve nënligjore.
5. Një pasqyrë të përgjithshme të zbatimit të ligjit për eficientë të energjisë që nga miratimi i tij si dhe pala shqiptare informoi mbi miratimin e ligjit mbi etiketimin e produkteve me ndikim në energji.

Në fushën e *energjisë*, pala evropiane rekomandoi:

1. Komisioni theksoi rëndësinë e informacionit të siguruar nga pala shqiptare mbi situatën aktuale të linjës së interkonjeksionit 400 kV Shqipëri-Greqi, duke përfshirë dhe nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit dhe përgatitjen e projektit.
2. Komisioni përgëzoi punën për përditësimin e Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën (NECP) më qëllim rishikimin e objektivave, duke pasqyruar rekomandimet e Komunitetit të Energjisë.
3. Gjithashtu, përgëzoi krijim e tregut “të ditës në avancë”, i cili shënon një hap të rëndësishëm për integrimin në tregun e energjisë elektrike dhe kontribuon në sigurinë e furnizimit me energji elektrike. U theksuan dhe fakti që tregu “brenda ditës” është ende në proces dhe rekomandoi marrjen e masave konkrete. Komisioni përgëzoi dhe anëtarësimin e plotë të APLEX në Europex, si dhe theksoi rëndësinë e progresit që duhet bërë në lidhje zbatimin e Kodeve të Rrjetit të Lidhjes.
4. Sa i takon eficientë të energjisë, Komisioni nënvizoi se prioritet për Shqipërinë mbetet ende miratimi i akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit për Eficientë të Energjisë; miratimi i rregulloreve për etiketimin e produkteve të energjisë; miratimi i strategjisë afatgjatë të rinovimit të ndërtesave me mekanizëm të qëndrueshëm financimi.

Në lidhje me rekomandimet e palës evropiane mbi çështjet konkrete të sektorëve të energjisë, pala shqiptare shprehu konsideratat për mbështetjen e Komisionit Evropian, si dhe ritheksoi agazhimin serioz të Shqipërisë për të vijuar punën për ndjekjen e dhe raportimin e progresit të tyre deri në takimin e radhës së Nënkomitetit në vitin 2025.

Në fushën e *zhvillimit rajonal*, pala shqiptare paraqiti përparimin e bërë duke u fokusuar në:

1. Hapat e ndërrmarra në lidhje me zbatimin e ligjit nr 102/2020 “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”, si dhe punën për plotësimin e akteve nënligjore dhe zbatimin e tyre. Tre Vendime të Këshillit të Ministrave janë hartuar dhe procesi zyrtar i miratimit të tyre nga Këshilli i Ministrave ka nisur;
2. Riorganizimin e grupit ndërinstitucional të punës për kapitullin 22 për të përfshirë të gjitha institucionet përgjegjëse, si dhe ngritjen e nëngrupit të punës mbi kushtet mundësuese, i drejtuar nga SASPAC;

Në fushën e *zhvillimit rajonal*, pala evropiane rekomandoi që:

1. Zbatimin praktik të Ligjit nr 102/2020 “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin” dhe për masat që planifikohen të ndërmerren nga ana e Shqipërisë për vijimin e zbatimit të tij. Pritet që i gjithë kuadri legjislativ të miratohet dhe jetë në fuqi sa më parë, duke mundësuar programimin shumë-vjeçar në nivel kombëtar dhe, aty ku është e nevojshme, atë lokal/rajonal.
2. Shqipëria duhet të përmirësojë, si sistemin e saj të monitorimit ashtu edhe sistemin e saj kombëtar të vlerësimit, për të siguruar përafrimin me kërkesat e legjislacionit të politikës së kohezionit të BE-së;
3. Vijimin e punës drejt përmbushjes së kushteve të ardhshme mundësuese *enabling condition*” për politikën e kohezionit;
4. Forcimin dhe ngritjen e kapaciteteve administrative, duke pëfshirë plotësimin me staf dhe politikën e qëndrueshmërisë së stafit për politikën e ardhshme të kohezionit, për programet të cilat janë në vazhdim si dhe, për strukturat e tjera IPA;
5. Pjesëmarrjen proaktive të Shqipërisë në Strategjinë e BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit (EUSAIR), duke patur një rol specifik në shtyllën e katërt ‘për turizimin e qëndrueshëm’.

Në lidhje me rekomandimet e palës evropiane mbi çështjet konkrete të zhvillimit rajonal, pala shqiptare shprehu konsideratat për mbështetjen e Komisionit Evropian, si dhe ritheksoi agazhimin serioz të Shqipërisë për të vijuar punën për ndjekjen e dhe raportimin e progresit të tyre deri në takimin e radhës së Nënkomitetit në vitin 2025.

1.5.3 Plani Kombëtar për Integrimin Evropian

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian është dokumenti kombëtar planifikues për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Ai pasqyron planifikimin për një periudhë 3 - vjeçare të politikave, kuadrit ligjor dhe administrativ dhemasave zbatuese.

Gjatë hartimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 – 2026, nga institucionet kryesuese të kapitujve të *acquis* dhe grupet ndërinstitucionale të punës të ngritura për secilin kapitull të *acquis*, u mbajtën parasysh:

- rekomandimet e takimeve me institucionet e përbashkëta, ngritur në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit,
- rekomandimet e raporteve vjetore të Komisionit për Shqipërinë,
- prioritizimet në bazë të analizave të mangësive legislative e administrativo-institucionale të bërë nga grupet ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian, kryer në kuadër të procesit *screening*,

- raporti *screening* i përgatitur nga shërbimet e Komisionit Evropian për grupkapitullin e parë “Themelorët”.

Zbatimi i Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 – 2026 monitorohet rregullisht, siç përcaktohet në vendim nr. 16, datë 11.1.2024 të Këshillit të Ministrave.

Monitorimi i Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 – 2026

Nga monitorimi i realizimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 – 2026, vërehet se, gjatë periudhës Janar-Qershor 2024, janë miratuar 22 akte ligjore nga 102 akte të planifikuara në total, nga të cilat 11 akte janë miratuar gjatë periudhës prill – qershor 2024.

Si më poshtë vijon, aktet e miratuara gjatë periudhës raportuese:

1. Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe Planit të Veprimit 2024-2026", miratuar në mbledhjen e Këshillit të Ministrave datë 2.5.2024;
2. Projektvendimi "Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik", është miratuar në mbledhjen Këshillit të Ministrave datë 15.05.2024;
3. Vendim i Bordit Vendimmarrës të AMA-s, Nr.40, datë 26.04.2024 për miratimin e rregullores "Për Kriteret dhe Procedurat e Shqyrtimit të Ndryshimeve në Strukturën e Pronësisë dhe Transparencën e të dhënave të Lidhura me Pronësinë e OSHMA-ve";
4. Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit përmes riintegrit social", miratuar në mbledhjen e datës 19.06.2024, të Këshillit të Ministrave;
5. Urdhër i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr.79, datë 15.4.2024 "Për miratimin e rregullores mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra";
6. Urdhër i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 83, datë 22.4.2024;
7. Projektvendim i Këshillit të Ministrave nr. 411, datë 19.06.2024 “Për miratimin e Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil”;
8. Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Rregullores “Nivelet e lejuara të radiobërthamave në ujin për konsum njerëzor, për mbrojtjen e publikut" nr. 403, datë 19.6.2024;
9. Udhëzim i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 9, datë 18.04.2024 "Mbi kërkesat për miratimin e stabilimenteve që prodhojnë filiza";
10. Urdhër i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 449, datë 13.06.2024 "Për miratimin e rregullores "Për lëvizjen jotregtare të zogjve të shoqërimin";
11. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 64/2012 “Për peshkimin” miratuar në Mbledhjen e Qeverisë datë 26.06.2024.

PJESA II: NEGOCIATAT PËR ANËTARËSIMIN NË BASHKIMIN EVROPIAN

Zhvillimi i Konferencës së Parë Ndërqeveritare, më 19 korrik 2022, shënoi fillimin zyrtar të negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Hapja e negociatave mbi bazë merite ishte një arritje historike për Shqipërinë, por në të njëjtën kohë ajo shënoi edhe fillimin e një procesi transformues të gjithanshëm për Shqipërinë.

Menjëherë pas Konferencës së Parë Ndërqeveritare, më 15 shtator 2022, filloi procesi i shqyrtimit analitik të *acquis* (screening), si hapi i parë i negociatave të anëtarësimit, ku për 14 muaj u zhvilloi intesivisht, me diligence dhe profesionalizëm të vlerëuar nga Komisioni Evropian dhe vendet anëtare, procesi bazë i përgatitjes për negociatat me Bashkimin Evropian – shqyrtimi i gjendjes së sistemeve, tregjeve dhe legjislacionit të vendit përkundrejt plotësisht të kriterëve dhe standarteve për anëtarësim në Bashkimin Evropian, në 36 fusha të sistemit të qeverisjes publike, ekonomisë dhe shoqërisë. Prosesi u finalizua me sukses në nëntor të vitit 2023.

Gjatë periudhës së raportimit (prill- qershor 2024), është progresuar në disa drejtime, si më poshtë vijojnë:

- ✓ *Konsolidimi i Rezolutës "Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për "Shqipërinë 2030" në Bashkimin Evropian"*

Kuvendi miratoi Rezolutën "Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian", që vendos objektivin kombëtar të arritjes së kriteve për anëtarësim në Bashkimin Evropian brenda vitit 2030.

Kjo iniciativë mbështet zbatimin e rekomandimeve të Bashkimit Evropian dhe të angazhimeve të Shqipërisë në masat e parashikuara në 3 Udhërrëfyesve (Shteti i së Drejtës, Sundimi i ligjit dhe Reforma në Administratë Publike), të cilat janë detyrime të Shqipërisë në kuadër të negociatave për Grupimin e parë "Themelorët", kryesisht në:

- Mirëqeverisjen
- Sundimin e ligjit
- Antikorrupsioni

- ✓ *Zbatimi i Udhërrëfyesit 'Shteti i së Drejtës'*

- Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 736 datë 13.12.2023 "Për miratimin e udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës", Ministria e Drejtësisë në cilësinë e institucionit lider për Kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore" ka iniciuar procesin e koordinimit dhe monitorimit për zbatimin e masave të parashikuara në këtë Udhërrëfyes.
- Në këtë kuadër, më datë 4 prill 2024, në bashkëpunim dhe me projektin JUST AL është zhvilluar një workshop me qëllim adresimin e saktë dhe monitorimin efikas të masave të Udhërrëfyesit.
- Projekti JUST AL ka përgatitur një listë pyetjesh orjentuese për të gjitha institucionet me qëllim adresimin e saktë të masave të parashikuara në Udhërrëfyesin e Shtetit të së Drejtës.
- Gjithashtu, Ministria e Brendshme, në cilësinë e institucionit lider për kapitullin 24 "Drejtësia, Liria dhe Siguria", si bashkëkontribuese në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës, gjatë periudhës mars-prill 2024, ka zhvilluar takime me eksperte të huaj për zërthimin e udhërrëfyesit dhe janë hartuar 11 matrica me masat konkrete sipas fushave që i përkasin

kapitullit 24 .

Zbatimi i masave të parashikuara në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës paraqet një hap të rëndësishëm drejt forcimit të Sundimit të Ligjit dhe përmbushjes së kriterëve të anëtarësimit në BE.

✓ *Zbatimi i Udhërrëfyesit 'Reforma e Administratës Publike'*

- Udhërrëfyesi "Reforma e Administratës Publike 2023-2030" është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 737, datë 13.12.2023, "Për miratimin e Udhërrëfyesit për Reformën e Administratës Publike 2023-2030". Institucioni përgjegjës për të koordinuar dhe monitoruar zbatimin e Udhërrëfyesit të RAP është Departamenti i Administratës Publike (DAP) dhe Negociator për RAP. Procesi është nën kujdesin e Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, si drejtues politik i të Reformës në Administratën Publike.
- Në janar dhe qershor 2024 (çdo tre muaj) ka nisur procesi i monitorimit të ecurisë së masave të parashikuara në Udhërrëfyesin e RAP për periudhën 2024 deri në qershor 2030.
- Pavarësisht monitorimit të progresit veçanërisht për masat që pritet të përfundojnë brenda vitit 2024, institucionet kanë përcaktuar, detajuar dhe planifikuar masat specifike për periudhën në vijim me synim kryesor përmbushjen e prioriteteve që parashikohen të përfundojnë brenda vitit 2024.

Deri në këtë fazë, evidentohet një progres solid dhe një përkushtim serioz nga institucionet kryesore pjesë e udhërrëfyesit të RAP për të ndjekur atë që është marrë si angazhim nga ana jonë në procesin e integritetit (me fokus në masat e parashikuara për vitin 2024), specifikisht gjatë kësaj periudhe:

- Në kuadër zbatimit të masave, është hartuar dhe aprovuar me Vendimin Nr. 390, datë 12.6.2024 të Këshillit të Ministrave, Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike (SMFP) 2023-2030.
- Departamenti i Administratës Publike (DAP), si institucioni përgjegjës për monitorimin e zbatimit të SNRAP, ka nisur procesin e hartimit të strategjisë së re duke organizuar disa takime konsultative 29 dhe tryeza partneriteti përgjatë procesit të deritanishëm të hartimit të Strategjisë. Gjatë periudhës raportuese janë marrë masa për të finalizuar draft-dokumentin strategjik në linjë me masat e parashikuara në Udhërrëfyes.

✓ *Dakortësimi dhe përfundimi i draft Udhërrëfyesit 'Funksionimi i Institucioneve Demokratike'*

- Udhërrëfyesi për 'Funksionimin e Institucioneve Demokratike' është një dokument politik dhe strategjik i cili paraqet masat kryesore që parashikohen të merren në kuadër të procesit të adresimit të gjetjeve të paraqitura nga Komisioni Evropian në raportin e shqyrtimit analitik (Screening Report) për Shqipërinë për sa i përket Kriterit Politik, kryesisht Funksionimit të Institucioneve demokratike. Qëllimi i hartimit të tij është të paraqesë masat politike kryesore që vendi ynë merr në procesin e negociatave për anëtarësim në BE për sa i përket Funksionimit të Institucioneve Demokratike. Dokumenti është hartuar pas një analize të akteve ligjore dhe kapaciteteve institucionale të institucioneve dhe aktorëve të përfshirë në kriterin politik kryesisht funksionimin e institucioneve demokratike në vijim të procesit "screening". Ky dokument është konsultuar në mënyrë të vazhdueshme me shërbimet e Komisionit Evropian është finalizuar drafti dhe pritet miratimi i tij.

✓ *Mekanizmi dhe strukturat e qeverisjes për integrimin evropian*

Në këtë periudhë raportuese rezulton se Grupi Negociator, kanë qënë produktiv dhe ka luajtur një rol aktiv në koordinimin e punës për arritjen e rezultateve të synuara lidhur hapjen e negociatave, si dhe përmbushjen e detyrimeve në kuadër të zbatimit dhe raportimit të MSA-së. Më specifikisht, është zhvilluar një (1) takim i Grupit Negociator në këtë periudhë, ku fokusi kryesor ka qënë përgatitja teknike për hapjen e negociatave dhe plani i Rritjes/Growth Plan & agjenda e reformave.

Lidhur me veprimtarinë e strukturave negociuese/Grupet Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian, gjatë periudhës Prill-Qershor 2024 rezulton se kanë zhvilluar rreth 72 takime, në 36 GNPIE-të, ku janë të angazhuar rreth 1972 anëtarë. Referuar Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian, gjatë periudhës raportuese 235 nëpunës civilë janë trajnuar përmes skemës së trajnimit të Sekretariatit të Integritit Evropian, ku 203 janë trajnuar përmes skemave të shkëmbimit të njohurive me Komisionin Evropian në kuadër të procesit të integritit, dhe 32 anëtarë janë trajnuar përmes skemave të shkëmbimit të njohurive me institucione të vendeve anëtare. Tematikat e trajnimeve adresojnë çështje të ndryshme, si (i) identifikimin e nevojave për trajnim në të ardhmen për çështje me natyrë të përgjithshme të lidhura me procesin e Integritit, ashtu si edhe për çështje me natyrë specifike të lidhura ngushtësisht me politikën që mbulon çdo GNPIE, (ii) funksionalitetet e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian dhe Anëtarësimin (PIEA); (iii) iniciimin e Kornizës së Përbashkët të Vlerësimit (CAF) lidhur me vlerësimin e kapaciteteve dhe strukturave për integrimin evropian dhe anëtarësimin në Bashkimin Evropian, në përputhje me metodologjinë e re për zgjerim të Komisionit Evropian, etj.

Për periudhën raportuese prill-qershor 2024 rezulton se janë zhvilluar 16 mbledhje/tryeza të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, me një pjesëmarrje në total të 237 aktorëve/grupeve të interesit si ekspertë të fushës (50), përfaqësuesve nga shoqëria civile (52), përfaqësuesve nga akademika/universitetet (71), përfaqësuesve nga pushteti vendor (24), përfaqësuesve të organizatave punëmarrëse (5), përfaqësuesve të biznesit (29) dhe media (6).

2.1 Grupimi i parë i kapitujve “Themeloret”

Ky grupim përbën bazën e shtetit të së drejtës. Ai paraqet direktivat dhe pëafrimin për ngritjen e një sistemi gjyqësor të pavarur, të paanshëm dhe eficient dhe një sistem mbrojtjeje efektiv të të drejtave themelore, çështje të sigurisë, luftën ndaj korrupsionit, krimi i organizuar apo emigracioni i paligjshëm (kapitulli 23, kapitulli 24, kriteri “Funksionimi i institucioneve demokratike”) etj.

Në këtë grupim kapitujsh janë përfshirë dhe çështje me karakter ekonomik, si prokurimet publike (kapitulli 5) apo kontrolli financiar (kapitulli 32). “Statistikat” është gjithashtu një kapitull i rëndësishëm, pasi gjatë të gjithë kapitujve dhe grupimeve të kapitujve, gjatë negociatave do të duhet të sigurojmë të dhëna reale, të besueshme dhe të japim statistika reale për fushat specifike (kapitulli 18).

Procesi screening për grupimin e parë të kapitujve filloi zyrtarisht në 15 shtator 2022 dhe u finalizua më 16 janar 2023. Të gjitha strukturat negociuese të përfshira në grupimin e parë bënë një punë intensive për finalizimin e procesit screening brenda afatit.

Pas përfundimit të takimeve screening për grupimin e parë të kapitujve “Themeloret”,

Komisioni Evropian në 20 korrik 2023, publikoi draft raportin e shqyrtimit analitik (Screening Report⁹), i cili pasqyron gjetjet e Komisionit Evropian për situatën aktuale të vendit përkundrejt kërkesave të EU acquis për “Themeloret”.

Në kuadër të dërgimit të Raportit *Screening* nga Komisioni Evropian, janë ndërmarrë masat në përputhje me metodologjinë e zgjerimit të BE-së, specifikisht si më poshtë vijon:

- Përgatitjen e piketave hapëse (Opening Benchmarks) për Grupimin e parë të kapitujve “Themeloret” të cilat janë: hartimi i Udhërrëfyesit të “Shtetit të së Drejtës” si dhe Udhërrëfyesi për “Reformën në Administratën Publike” sikurse paracaktuar në metodologjinë e zgjerimit. Këto dy dokumente u miratuan me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 736 datë 13.12.2023 "Për miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës", si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 737, datë 13.12.2023 “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Reformën në Administratën Publike 2023–2030”.
- Të dy Udhërrëfyesit përmbajnë prioritetet kyçe të reformave dhe drejtojnë negociatat e anëtarësimit në këto fusha, ndërsa Shqipëria po përgatitet të përmbushë kërkesat për anëtarësimin në BE, si dhe përcaktojnë në mënyrë strategjike dhe të fokusuar veprimet dhe reformat kyçe në fushat përkatëse me afate të qarta dhe sekuencën e hapave kyç të parashikuar. Udhërrëfyesit gjithashtu adresojnë boshllëqet që lidhen me kuadrin strategjik dhe legjislativ, me kapacitetin zbatues dhe institucional, si dhe me funksionimin e institucioneve publike dhe performancën e tyre në përputhje me standardet dhe legjislacionin përkatës të BE-së.
- Draft “Udhërrëfyesi për Funksionimin e Institucioneve Demokratike”, është një dokument politik dhe strategjik i cili paraqet masat kryesore që parashikohen të merren në kuadër të procesit të adresimit të gjetjeve të paraqitura nga Komisioni Evropian në raportin e shqyrtimit analitik (screening report) për Shqipërinë për sa i përket Kriterit Politik, kryesisht Funksionimit të Institucioneve demokratike. Qëllimi i hartimit të tij është të paraqesë masat politike kryesore që vendi ynë merr në procesin e negociatave për anëtarësim në BE për sa i përket Funksionimit të Institucioneve Demokratike përmban 138 masa.
- Në vijim të miratimit të piketave hapëse për negociatat, është hartuar draft Pozicioni Negociues për Grupkapitullin I “Themeloret”, siç parashikohet në metodologjinë e re të zgjerimit të BE-së, në përgjigje të Raportit të Vlerësimit Analitik të Komisionit Evropian, të miratuar mbi bazën e procesit të shqyrtimit analitik dypalësh (publikuar nga Komisioni Evropian në 20.7.2023).
- Pozicioni Negociues i Shqipërisë është dokumenti bazë mbi të cilin ndërtohet korniza e Negociatave të integritetit të saj në BE. Pozicioni negociues hartohet në përputhje me:
 - o Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 749, datë 19.12.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës Shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian” ku në pikën 5 parashikohet se: Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian vlerëson dhe bashkërendon qëndrimin negociues për secilin kapitull të acquis, të paraqitur nga Kryenegociatori, sipas përcaktimit në pikën 5, të kreut V, të këtij vendimi, me opinionin e Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian;
 - o Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 422, datë 6.5.2020 “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e Kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian” Kryenegociatori ka përgjegjësi për kryerjen e

⁹https://neighbourhoodenlargement.ec.europa.eu/system/files/202307/AL%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf

negociatave teknike të anëtarësimit në BE për të gjithë kapitujt negociues. Qëndrimi negociues për çdo kapitull dhe çdo dokument tjetër mbështetës, i përcillet Komisionit Evropian, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, në vijim të marrjes së opinionit nga Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian dhe shqyrtimit nga Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian;

- o Ligjin Nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian” (ndryshuar me ligjin nr. 19/2023, datë 16.3.2023) ku në nenin 14/1 parashikohen procedurat për shqyrtimin e pozicioneve negociuese nga Komisioni për Çështjet Evropiane si dhe në pikën 7 të tij ku parashikohet nënshkrimi i deklaratës së konfidencialitetit nga anëtarët të cilët marrin në shqyrtim këtë dokument.

Gjatë periudhës Prill-Qershor 2024 janë zhvilluar rreth 30 takime, në 8 GNPIE-të e Grupimit “Themeloret”, ku janë të angazhuar rreth 685 anëtarë.

Më specifikisht, në 30 takimet e zhvilluara të mekanizmit për Grupimin I ‘Themeloret’, disa nga çështjet e trajtuara, diskutuara dhe konsultuara lidhen me(i) Masat e parashikuara në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024-2026; (ii) Raporti vjetor 2023 i INSTAT; (iii) Hartimi i kontributit të parë të Komisionit Evropian për Shqipërinë 2024 dhe Realizimi i rekomandimeve afatshkurtra të dhëna në raportin vjetor të Komisionit 2023; (iv) konsolidimi i draft Pozicionit Negociues; (v) ecuria e përgatitjes së mekanizmit të monitorimit të udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës; (vi) Prezantimi i aktiviteteve dhe raporteve të fundit të Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore”; (vii) Ndjekja e procesit mbi evidentimin e nevojave institucionale në kuadër të shtyllave të RAP; (viii) Planifikimi i rritjes së pagave për nëpunësit civil dhe sektorët kyç të administratës, si dhe zbatimi i fleksibilitetit të orarit, vlerësimit të performancës dhe mundësisë së bonuseve, përbëjnë hapa kyç për energjizimin dhe motivimin e administratës publike në rrugën drejt anëtarësimit në BE për Shqipërinë në 2030; (ix) Diskutim mbi tek masat prioritare për energjizimin dhe motivimin e administratës publike shqiptare; (x) Draftimi i ndryshimeve në ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; (xi) Hartimin e Kornizës së Përbashkët të Vlerësimit (CAF) lidhur me vlerësimin e kapaciteteve dhe strukturave për integrimin evropian dhe anëtarësimin në BE; (xii) Mbi trajnimet dedikuara për funksionalitetin e Platformës së Integritit Evropian e Aderimit (PIEA); (xiii) mbi përditësimin e listës së anëtarëve të GNPIE si Përdorues të Platformës së Integritit Evropian dhe Anëtarësimit (PIEA); (xiv) Instrumentin e monitorimit të Paketës Semestrale për Integrimin Evropian për periudhën Prill-Qershor 2024.

Arritjet kryesore gjatë periudhës raportuese për Grupimin e parë “Themeloret”, paraqiten si më poshtë vijon:

Sa i përket arritjeve në fushën e drejtësisë, në lidhje me procesin e vettingut, për periudhën prill – qershor 2024, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka nxjerrë 29 vendime nga të cilat:

- o 22 vendime për konfirmimin në detyrë për 7 gjyqtarë, 5 prokurorë, 10 ndihmës/këshilltarë ligjorë;
- o 4 vendime për shkarkimin nga detyra për 1 gjyqtar, 2 prokurorë, 1 ndihmës ligjor;
- o 1 vendim për ndërprerje të procesit për 1 ndihmës ligjor.
- o 1 vendim për përfundimin e procesit pa një vendim përfundimtar për 1 ndihmës ligjor;
- o 1 vendim për pezullimin nga detyra për 1 prokuror.

- Institucioni i Komisionerëve Publikë, për periudhën 1 prill -30 qershor 2024, është njoftuar nga KPK për 29 vendime. Nga këto, Komisionerët Publikë kanë ankimuar 8 vendime në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit dhe për 16 vendime kanë vendosur të mos ushtrojnë ankim, ndërsa 5 vendime janë në proces shqyrtimi.
- Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit u ka paraqitur Komisionerëve Publikë 2 rekomandime për të ushtruar ankim.
- Në regjistrin e denoncimeve të publikut janë regjistruar 44 denoncime.
- Kolegji i Posaçëm i Apelimit është organi i vetëm gjyqësor që shqyrton ankimet e paraqitura nga subjektet e rivlerësimit apo Komisioneri Publik ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
- Për periudhën 1 prill – 30 qershor 2024, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit janë regjistruar 10 çështje të juridiksionit të rivlerësimit, nga të cilat 6 janë ankimuar nga Komisioneri Publik, 3 nga subjektet e rivlerësimit dhe 1 çështje është ankimuar edhe nga Komisioneri Publik, edhe nga subjekti i rivlerësimit.
- Deri më 30.06.2024, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit janë regjistruar në total 384 çështje, nga të cilat, 259 çështje kanë përfunduar. Aktualisht, janë duke u shqyrtuar 125 çështje, nga të cilat 11 çështje janë nën gjykim (6 në seancë publike dhe 5 në dhomë këshillimi), ndërsa 114 çështje janë me status përgatitje për gjykim.
- Për periudhën 1 prill – 30 qershor 2024, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit janë shpallur 18 vendime. Nga këto 18 çështje të cilat kanë përfunduar, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka vendosur:
 - o Lënien në fuqi të Vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit – në 12 vendime
 - o Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit - në 1 vendim
 - o Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit - në 1 vendim
 - o Prishjen e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. urdhërimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të vijojë procesin e rivlerësimit kalimtar – në 1 vendim
 - o Përfundimin e procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar për çështjen, për shkak se objekti dhe qëllimi është bërë i pamundur – në 1 vendim
 - o Ndryshimin e vendimit, pezullimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit për një periudhë një vjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës – në 1 vendim
 - o Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke ndërprerë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, ndalimin për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë të Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare – në 1 vendim
- Pjesëmarrja e publikut në denoncimin e fakteve është parashikuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016; në këtë kuadër, për periudhën 1 prill – 30 qershor 2024, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit janë regjistruar dhe trajtuar 38 denoncime.
- Në vijim të Rekomandimit të vazhdueshëm të Komisionit Evropian për miratimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shqipëri, është hartuar drafti final i projektligjit si dhe marrja e mendimeve për draft-aktin. Ky projektligj është i planifikuar edhe në PKIE 2024-2026.
- Në fushën e punëve të brendshme, gjatë kësaj periudhe u miratua Strategjia Kombëtare për Migracionin 2024 – 2030. të migracionit tek zhvillimi, në të mirë të migrantëve dhe shoqërisë shqiptare.

- Në këtë kuadër, u zhvillua Konferenca Ministrore e Vendeve të Ballkanit Perëndimor me temën "Bashkëpunim në Çështjet e Sigurisë dhe Fluksit të Migracionit përmes Ballkanit Perëndimor". Gjatë kësaj konference u firmos Deklarata e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Migracionit të Mbretërisë së Bashkuar, duke hapur rrugën për bashkëpunim më të ngushtë në menaxhimin e sfidave të përbashkëta.
- Me Urdhërin e Ministrit të Brendshëm nr. 56, datë 28.04.2024, u krijua Grupi i Punës "Për krijimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve", i kryesuar nga Zëvendësministri i Brendshëm Besfort Lamallari. Ky grup pune u mbledh disa herë gjatë vitit 2024 për të konkretizuar draftin e projektligjit përkatës.
- Gjithashtu, u prezantua projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Moldavisë, për bashkëpunimin policor", ky projektligj synon rritjen e efikasitetit në luftën kundër krimit dhe forcimin e bashkëpunimit për zhvillimin e operacioneve të përbashkëta policore me Republikën e Moldavisë, me synim kryesor luftën kundër krimit ndërkufitar.
- Në lidhje me Prokurimin Publik, gjatë kësaj periudhe, janë shënuar një sërë zhvillimesh që përfshijnë vendime të Këshillit të Ministrave dhe negociata ndërkombëtare.
- Fillimisht, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 304, datë 22.05.2024, u miratua Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik 2024-2030 dhe plani i saj i veprimit për periudhën 2024- 2027. Kjo strategji synon të përmirësojë dhe modernizojë sistemin e prokurimit publik në Shqipëri, duke vendosur standarde të reja dhe praktika më efektive.
- Gjithashtu, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 292, datë 15.05.2024, u bënë disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 768, datë 15.12.2021, që përcakton llojet e shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, si dhe rregullat e detajuara për prokurimin e tyre.
- Në datën 17.04.2024, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 245, u përcaktuan tarifat për kryerjen e veprimtarive ndihmëse për prokurimin publik nga shoqëria aksionare shtetërore "Operatori i Blerjeve të Përqendruara" sh.a. Ky vendim synon të rrisë efikasitetin dhe transparencën në procesin e prokurimit publik.
- Një tjetër zhvillim i rëndësishëm është Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 291, datë 15.05.2024, që përcakton kufijtë monetarë në procedurat e prokurimit publik. Ky vendim synon të qartësojë dhe rregullojë procedurat e prokurimit, duke përcaktuar pragjet financiare për çdo kategori shërbimesh dhe mallrash.
- Në kuadër të procesit të Negociatave për Aderimin e Shqipërisë në Marrëveshjen e Organizatës Botërore të Tregtisë për Prokurimet Qeveritare (GPA), oferta ekonomike e mbulimit të tregut u finalizua dhe dërgua pranë Sekretariatit Teknik të GPA më datë 23.05.2024. Për këtë qëllim, gjatë datave 10-12 Qershor 2024, në Gjenevë, Zvicër, delegacioni shqiptar, i kryesuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, zhvilloi takime bilaterale informale dhe formale me delegacionet e shteteve të tjera pjesëmarrëse në GPA, duke diskutuar për kushtet dhe përfitimet e mundshme të aderimit.
- Së fundmi, projektvendimi "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar", ka nisur procedurën e miratimit. Ky projektvendim synon të përmirësojë dhe përditësojë rregullat ekzistuese të prokurimit publik, duke u përshtatur me zhvillimet e fundit dhe nevojat aktuale të tregut.

Lidhur me fushën e Statistikave, gjatë kësaj periudhe, Instituti i Statistikave (INSTAT), me mbështetjen e Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendor, nënshkroi një memorandum

bashkëpunimi me bashkitë e vendit.

- Marrëveshja u nënshkrua nga titullari i INSTAT, znj. Elsa Dhuli, dhe përfaqësuesit e 61 bashkive në vend. Në zbatim të këtij memorandum, çdo bashki do të ketë një zyrë për mbledhjen e të dhënave statistikore, me mbështetjen e projektit Statistika të Forta Vendore (SALSTAT), mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.
- Gjithashtu një tjetër Memorandum Mirëkuptimi u nënshkrua ndërmjet INSTAT dhe Autoritetit Portual Durrës. Qëllimi i këtij memorandum është përmirësimi i kuadrit rregullator dhe operacional mbi mbarëvajtjen e proceseve logjistike dhe shërbimeve publike në fushën e logjistikës detare dhe zinxhirëve të furnizimit.
- INSTAT nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Agjencinë Kombëtare të Rinisë (AKR), me fokus statistikat mbi rininë. Kjo marrëveshje synon të forcojë bashkëpunimin për shkëmbimin e të dhënave statistikore dhe studimore për rininë, duke promovuar zhvillimin dhe trajnimin e stafit të AKR në fushën e prodhimit statistikor.
- INSTAT rishikoi dokumentin e draft Pozicionit Negociues për Kapitullin 18 "Statistikat" pas komenteve të marra nga Komisioni Evropian.
- Gjithashtu, INSTAT organizoi Konferencën Finale të Censit të Popullsisë dhe Banesave, ku publikoi të dhënat kryesore. Kjo konferencë shënoi një moment të rëndësishëm, duke theksuar përpjekjet e bëra gjatë procesit të censit si një prej proceseve statistikore më madhore dhe të rëndësishme që INSTAT realizon.
- Projektligji për "Censin e Bujqësisë dhe Fermave Bujqësore", i cili parashikohej për miratim në katërmujorin e parë të vitit 2024, është finalizuar dhe ka nisur procedurën e shqyrtimit dhe miratimit.
- Sa i përket Reformës në Administratën Publike, përgatitja e Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike (SNRAP) 2023-2030 udhëhiqet nga vizioni për forcimin dhe konsolidimin e administratës publike në rrugën drejt integritimit në Bashkimin Evropian. Departamenti i Administratës Publike (DAP), ka nisur procesin e hartimit të kësaj strategjie të re, përmes disa takimeve konsultative dhe tryezave të partneritetit.
- Gjatë periudhës Janar – 15 Maj 2024, janë ndërmarrë hapa për të finalizuar draft-dokumentin strategjik në përputhje me masat e parashikuara në Udhërrëfyes.
- Një aspekt kyç për zbatimin efektiv të angazhimeve të ndërmarra është kostimi i Planit të Veprimit, i cili po finalizohet me mbështetjen e projektit "EU for Good Governance" (EU4GG).

2.2 Grupimi i dytë i kapitujve "Tregu i brendshëm"

Në përputhje me metodologjinë e re të Bashkimit Evropian për zgjerimin, grupimi 2 i kapitujve "Tregu i brendshëm" është ndër grupimet më voluminoze, me 9 kapituj, që mbulojnë përkatësisht këto fusha: lëvizja e lirë e mallrave (kapitulli 1), lëvizja e lirë e punëtorëve (kapitulli 2), e drejta e themelimit dhe liria e ofrimit të shërbimeve (kapitulli 3), liria e lëvizjes së kapitalit (kapitulli 4), legjislacioni tregëtar (kapitulli 6), e drejta e pronësisë intelektuale (kapitulli 7), e drejta e konkurrencës (kapitulli 8), shërbimet financiare (kapitulli 9) dhe mbrojtja e shëndetit dhe konsumatorit (kapitulli 28). Procesi screening për grupimin e dytë filloi zyrtarisht në tetor të vitit 2022 dhe u finalizua në mars të vitit 2023. Të gjitha strukturat negociuese të përfshira në grupimin e dytë kanë bërë një punë të mirë dhe intensive për finalizimin e procesit screening (takime bilaterale), brenda 3 muajve (janar-mars 2023).

Komisioni Evropian finalizoi draft Raportin Screening për Grupin II "Tregu i brendshëm" në maj 2024 dhe ja kaloi për diskutim Këshillit Evropian. Pritet që Raporti të procedohet gjatë muajit shtator, 2024 dhe në vijim të tij, t'i kërkohet Shqipërisë të paraqesë pozicionin

negociues për këtë grupim (nëse nuk parashikohen kushte për çeljen e negociatave për këtë grupim, nga Këshilli). Në pararendje të Raportit Screening, Shqipëria filloi përgatitjet për hartimin e pozicionit negociues për Grupin II “Tregu i brendshëm”.

Këto përgatitje paraprake nga institucionet shqiptare sigurojnë një përgjigje të shpejtë ndaj kërkesave të Komisionit Evropian për përgatitjet teknike për negociata, si dhe do të bëjnë të mundur progresim më të shpejtë në hapjen e negociatave, në përputhje me objektivin, për hapjen e sa më të shpejt dhe sa të më shume grupimeve gjatë vitit 2024 – 2025.

Gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar 6 takime, në 9 GNPIE-të e Grupimit “Tregu i Brendshëm”, ku janë të angazhuar rreth 114 anëtarë.

Disa nga çështjet që mekanizmi i qeverisjes për integrimin evropian për Grupimin II “Tregu i Brendshëm” ka ndjekur gjatë kësaj periudhe raportuese lidhen me (i) ndjekjen e monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025; (ii) konsolidimi i paketës raportuese lidhur me organizimin efikas të Nënkomitetit të “Tregu i Brendshëm (në Maj 2024); (iii) konsolidimin e draft Pozicionit Negociues për grupimin, (iv) adresimi i rekomandimeve të raport-progresit; (iv) marrjen në konsideratë të gjetjeve të analizës ligjore për projektligjin e tokës bujqësore; (v) përfaqësimin në Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social (KESE) si pjesë e projektit pilot që po ndërmerret Komisioni Evropian për vendet e Ballkanit Perëndimor; (vi) konsolidimin e nevojave për trajnim të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian; (vii) finalizimin e pyetësorit për Tryezat e Diskutimit për Platformën e Partneritetit për Integrimin Evropian; (viii) ndjekje e Planit Menaxherial (Semestral) i Integritimit Evropian për Forcimin e Kapaciteteve Administrative (PSIE 2024) për Grupimin’ (ix) përdorimi dhe funksionalizimi i Platformës së Integritimit Evropian dhe Anëtarësimit (PIEA), etj.

Arritjet kryesore gjatë periudhës raportuese të Grupimit të dytë të kapitujve të “Tregut të Brendshëm”, lidhur me procesin e negociatave dhe anëtarësimin në Bashkimin Evropian paraqiten, si më poshtë vijon:

- Në lidhje me shërbimet financiare, gjatë periudhës raportuese Banka e Shqipërisë vijon punën drejt plotësisht të “paketës së rezervave makroprudencialë të kapitalit me rezervë kapital për rrezikun sistemik (STRUK)”. Bankat e nivelit të dytë nisën raportimin e modeleve të rregulloreve për herë të parë në Prill të vitit 2024. Miratimi dhe zbatimi i kësaj rregulloreje përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt përafrimit të kuadrit makroprudencial të vendit me legjislacionin dhe praktikën e ndjekura nga vendet e Bashkimit Evropian.
- Në kuadër të anëtarësimit të përshpejtuar në zonën Gjeografike të SEPA-s, lidhur me Sistemet e Pagesave, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim të ngushtë me një sërë institucionesh shtetërore si dhe me mbështetjen e Komisionit Evropian (DG FISMA) dhe Komisionit Evropian të Pagesave (European Payment Council -EPC), në datë 13 qershor 2024, ka dërguar aplikimin zyrtar të Shqipërisë pranë EPC për anëtarësimin në zonën gjeografike të Sistemit Unik të Pagesave në Euro (SEPA).
- Në kuadër të zbatimit të Udhërrëfyesit për zbatimin e regjimit “Solvency II”, ka filluar puna për forcimin e kapaciteteve, në bashkëpunim me ekspertë të Bankës Botërore, në kuadër të Projektit të “Qëndrueshmërisë dhe Zhvillimit Financiar në Shqipëri”.
- Në lidhje me lëvizjen e lirë të kapitaleve, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në kuadër të aplikimit në SEPA ka miratuar në datën 3 Prill 2024 një rregullore “Për përcaktimin e kërkesave për transfertat e kredisë dhe debitimet direkte në Euro”, që transponon nenin 5 të Rregullores SEPA. Objekti i zbatimit i kësaj rregulloreje lidhet me

- rregullimin e transaksioneve ndërkufitare në Euro. Me miratimin e kësaj rregulloreje, në përmbushje të të gjitha kërkesave për t'u bërë pjesë e SEPA/ (Single Euro Payment Area), Banka e Shqipërisë aplikoi zyrtarisht për tu bërë pjesë e SEPA në 16.6.2024.
- Gjatë periudhës raportuese, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Banca d'Italia, po vlerëson fizibilitetin e zbatimit të një zgjidhjeje kombëtare të ngjashme me TIPS të BE (Pagesat e menjëhershme të synuara) ku efektet pozitive do të materializohen në treg në përdorimin e pagesave elektronike me ngritjen dhe funksionalizimin e Sistemit të Pagesave Instante në Shqipëri. Banka e Shqipërisë ka vijuar të zhvilloj dhe zbatoj një zgjidhje pagese të menjëhershme për tregun me pakicë, për të ofruar disponueshmëri 24/7. Pagesat e menjëhershme konsiderohen të vlefshme për sa i përket uljes së kostove, rritjes së efikasitetit të pagesave, përmirësimit të tregtisë elektronike dhe rritjes së përfshirjes financiare.
 - AMF në zbatim të ligjit të 76/2023 “Për fondet e pensionit privat” ka hartuar dhe miratuar rregulloret e mëposhtme:
 - o Rregullore Nr. 91, datë 31.05.2024 “Për përcaktimin e kushteve dhe kritereve që duhet të plotësojë personi juridik i cili do të veprojë si agjent i fondit të pensionit privat”;
 - o Rregullore Nr. 58, datë 30.04.2024 “Për njohjen e administruesit të fondeve të investimeve alternative të licencuar në një vend anëtar të BE-së dhe regjistrimin e fondit të investimeve alternative të themeluar në një vend anëtar të BE-së”;
 - o Rregullore Nr. 59, datë 30.04.2024 “Për miratimin e disa shtesave në rregulloren nr. 38, datë 31.03.2023, “për regjistrimin e agjentit të shitjes së sipërmarrjeve të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm të miratuara në një vend anëtar të BE-së.
 - Në lidhje me pronësinë intelektuale dhe industriale, në fushën e të drejtës së autorit, është punuar intensivisht që në Gusht 2024, Drejtoria e së Drejtës së Autorit, të nisë procedurën e licencimit ose rinovimit të licencimit të Organizatave të Menaxhimit Kolektiv. Gjithashtu, sipas qasjes one stop shop, do të shqyrtohet dhe miratohet statuti i ri për organizatat e reja dhe strukturën e re të së drejtës së autorit. Në fushën e pronësisë industriale, në linjë me rekomandimet e Komisionit Evropian, dhënë në takimin e 15-të të Nënkomitetit të Tregut të Brendshëm dhe Konkurrencës zhvilluar më 30 maj, 2024, është punuar me draft ligjet e reja për markat dhe patentat, dhe në korrik 2024, i janë dërguar shërbimeve të Komisionit Evropian.

2.3 Grupimi i tretë i kapitujve “Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse”

Në përputhje me metodologjinë e re të Bashkimit Evropian për zgjerimin, Grupimi i tretë “Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse” përfshin çështje si transformimi digjital, media (kapitulli 10), shkenca dhe kërkimi shkencor (kapitulli 25), ndërmarrjet dhe politikat industriale (kapitulli 20), punësimi dhe politikat sociale (kapitulli 19), arsimi dhe kultura (kapitulli 26). Në pjesën ekonomike, ky grupim mbulon bashkimin doganor (kapitulli 29), politikën ekonomike dhe monetare (kapitulli 17) dhe taksimin (kapitulli 16).

Procesi screening për Grupimin e tretë filloi zyrtarisht në tetor të vitit 2022 dhe u finalizua në qershor të vitit 2023. Të gjitha strukturat negociuese të përfshira në Grupimin e tretë kanë bërë një punë të mirë intensive për finalizimin e procesit screening brenda 4 muajve (mars – qershor 2023).

Përgjatë periudhës raportuese, për çdo kapitull respektivisht kanë filluar përgatitjet dhe analiza për hartimin e draft pozicionit negociues për Grupimin e tretë.

Gjatë periudhës Prill-Qershor 2024 janë zhvilluar rreth 13 takime, në 8 GNPIE-të e Grupimit III “Konkurrueshmëria Dhe Rritja Gjithpërfshirëse” ku janë të angazhuar rreth 479 anëtarë.

Disa nga çështjet që mekanizmi i qeverisjes për integrimin evropian për Grupimin III “Konkurrueshmëria dhe Rritja Gjithpërfshirëse”, ka ndjekur gjatë kësaj periudhe raportuese lidhen me (i) përgatitjen e dokumentit të draft pozicionit negociues ; (ii) finalizimin e dokumentit për Future Plans, Integrimin e Përshpejtuar dhe Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor (Growth Plan) (iii) përparimin në përafrimin e akteve të planifikuara në PKIE 2024-2026 brenda afateve të parashikuara; (iv) plotësimi i Pyetësorit mbi vlerësimin e kapaciteteve (CAF); (v) përdorimin dhe funksionalizimin e Platformës së Integritimit Evropian dhe Anëtarësimit (PIEA); (vi) përditësimin e listës së anëtarëve të GNPIE si Përdorues të Platformës së Integritimit Evropian dhe Anëtarësimit (PIEA).

Arritjet kryesore gjatë periudhës raportuese të Grupimit të tretë të kapitujve të “Konkurrueshmërisë dhe rritjes gjithëpërfshirëse”, lidhur me procesin e negociatave dhe anëtarësimin në Bashkimin Evropian paraqiten, si më poshtë vijon:

Në fushën e politikave sociale dhe punësimit:

- U miratua Urdhri i Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 323, date 22.05.2024 "Për ngritjen e grupit të punës për ndryshimin e Rregullores së funksionimit të Këshillit Kombëtar të Punës”.
- Në kuadër të forcimit të kapaciteteve të institucioneve të pavarura për të punuar në mënyrë më efektive me çështjet e diskriminimit në punë (në vazhdimësi), në datat 12-13 Qershor 2024 zhvilloi punimet Konferenca Rajonale për “Strehimin e Romëve” në Tiranë në bashkëpunim midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit me mbështetjen e Këshillit të Europës.
- Gjatë tremujorit të dytë 2024, në kuadër të përmirësimit të politikave dhe programeve të punësimit, për t’i bërë më të përshtatshme, për të rritur gamën e përfituesve dhe përfitimin financiar janë bërë ndryshimet e 2 VKM-ve kryesore të cilat janë:
 - o (i) programi i punëve publike në komunitet (PPK) (VKM Nr. 535 dt 08.07.2020), i ndryshuar se fundmi me Vendimin nr. 241, datë 17.4.2024, ku ndryshimet konsistuan në uljen e moshës minimale të përfshirjes në program nga 25 në 21 vjeç (dhe në kontekstin e Garancisë Rinore), rritjen e vlerës financiare të bonuseve, të evidentimit të kohëzgjatjes së papunësisë nëpërmjet sistemit të tatimeve, rritjes së numrit të përfituesve për subjektet përfituese nga 14 në 24 punëkërkues të papunë maksimumi dhe në dhënien e pagesave për OJF në formë granti në mënyrë që të lehtësohet përfshirja e tyre në programe;
 - o (ii) programi i punësimit/formimit në punë/praktikave profesionale (VKM Nr.17 dt 15.01.2020), i ndryshuar së fundmi me Vendimin nr. 239, datë 17.4.2024, ku më specifikisht ndryshimet në programin PPK, konsistojnë në heqjen e kriterit 1 mujor për të qenë të regjistruar në zyrën e punës, rritjen e vlerës financiare të bonuseve, rritjen e periudhës së përfitimit për të rinjtë 15-29 vjeç nga 4 në 6 paga, rritjen e pagesës së mentorit për programin e formimit në punë, lehtësimin e procedurave të verifikimit të dokumentacionit të subjekteve nëpërmjet ndërveprimit elektronik të sistemeve.

Në fushën e transformimit digjital dhe medias:

- Është miratuar Ligji nr. 54/2024 datë 30.5.2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, që transpozon direktiven e BE-së 2018/1972/EU, Kodi Europian i Komunikimeve Elektronike. Ligji nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” është botuar në fletoren zyrtare më datë 20.6.2024;
- Autoriteti i Mediave Audiovizive miratoi Vendimin nr. 40 datë 26.04.2024 “ Për miratimin e rregullores “ Për kriteret dhe procedurat e shqyrtimit të ndryshimeve në strukturën e pronësisë dhe transparencën e të dhënave të lidhura me pronësinë OSHMA-ve”.

Në fushën e ndërmarrjeve dhe politikave industriale:

Është miratuar Urdhëri Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Nr. 364, datë 30.05.2024 “ Për emërimin e anëtarëve të këshillit konsultativ për ndërmarrjet” .

Në fushën e tatimeve: Objektivi i Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave (MTRS) 2022-2026 është rritja e të ardhurave tatimore me +2.5 % e PBB-së, krahasuar me vitin bazë, duke arritur në vitin 2027 në 27.7 % e PBB-së. Me qëllim realizimin e objektivit, Ministria e Financave ka filluar procesin e rishikimit të Strategjisë (MTRS për periudhën 2024, duke u përqëndruar kryesisht në adresimin e problematikave të administrimit tatimor dhe doganor, nga përmirësimi i të cilave pritet të gjenerohen të ardhura shtesë.

Gjatë muajit qershor 2024 u hartua drafti i parë i Strategjisë së rishikuar, i cili më pas do lancohet për konsultim publik dhe pas marrjes së sugjerimeve nga palët e interesuara vijon procedura për miratimin në 4 mujorin e fundit të vitit 2024.

Në fushën e Shkencës dhe Kërkimit Shkencor:

MAS dhe AKKSHI, në bashkëpunim me AKSHI-në, do të krijojnë një platformë digjitale “Albania Current Research Information System” (ACRIS) ku të përfshihen të gjitha data bazat e informacionit për i) titujt akademik dhe gradat shkencore, ii) kërkuesit shkencor, iii) botimet shkencore, iv) ifrastrukturën e kërkimit shkencor, v) platforma aplikimi për projektet e kërkimit shkencor etj.

Në fushën e Arsimit dhe Kulturës

Në kuadër të Programit Kombëtar të Zhvillimit Profesional të Mësuesve 2024 – 2025, i cili është duke u zbatuar nga shtatë institucione e arsimit të lartë, gjatë periudhës prill - qershor 2024, janë trajnuar 8465 mësues të lëndëve gjuhë shqipe, matematikë, fizikë, biologji, kimi, arsim fillor. Janë angazhuar 166 pedagogë si trajnerë për zbatimin e metodave efektive në procesin mësimor, përdorimin e platformave interaktive dhe teknologjisë në procesin mësimor, nxitjen e përfshirjes së nxënësve në zbatimin e njohurive dhe të aftësive lëndore në situata të jetës reale sipas qasjes STEM.

Në kuadër të mbështetjes së ofruar për organizatat rinore për zbatimin e projekteve rinore, gjatë muajit qershor 2024 janë shpallur rezultatet e projekteve fituese të Thirrjes së Katërt për projekt-propozime rinore të Agjencisë Kombëtare të Rinisë, e cila është çelur më datë 17 Prill, 2024 dhe qëndroi e hapur deri më 16 Maj 2024. Këto projekte do të adresojnë tre prioritetet kryesore të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029: nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe mbështetjen e aktivizmit shoqëror dhe qytetar të tyre; nxitjen e punësimit të denjë dhe ndërlidhjes së të rinjve me tregun e punës; dhe mbështetjen e mirëqenies aktive, të shëndetshme, fizike, sociale, kulturore dhe mendore të

të rinjve.

2.4 Grupimi i katërt i kapitujve “Agjenda e Gjelbër dhe Ndërlidhja e Qëndrueshme”

Në përputhje me metodologjinë e re të Bashkimit Evropian për zgjerimin, grupimi i kapitujve 4 “Agjenda e Gjelbër dhe lidhshmëria e qëndrueshme” mbulon katër fusha të rëndësishme: politikën e transportit (kapitulli 14), energjinë (kapitulli 15), rrjetet trans-evropiane (kapitulli 21) si dhe mjedisin dhe ndryshimet klimatike (kapitulli 27). Të katër kapitujt përmbajnë detyrimet për të përmirësuar legjislacionin në fushat përkatëse, si edhe investime infrastrukturore dhe institucionale për të mbikëqyrur përmbushjen e objektivave të vendosur nga legjislacioni evropian. Në këtë grupim, Bashkimi Evropian është angazhuar në “Agjendën e Gjelbër” si dhe në “Planin Ekonomik të Investimeve” për vendet e Ballkanit Perëndimor për të rritur dhe përmirësuar investimet në rajon, duke mobilizuar deri në 9 miliardë € nga Instrumenti i IPA III, me qëllim nxitjen e rimëkëmbjes afatgjatë - të orientuar drejt tranzicionit të gjelbër dhe atij digjital. Plani Ekonomik i Investimeve të BE për Ballkanin Perëndimor identifikon 10 (dhjetë) iniciativa “Flagships” të investimeve në fushat kryesore siç janë: transporti i qëndrueshëm, energjia e rinovueshme dhe transformimi i gjelbër.

Gjithashtu, Plani i ri i Rritjes për Ballkanin Perëndimor, i lancuar si propozimi i Komisionit Evropian në datën 8 nëntor 2023, me qëllim për të sjellë në vendet candidate në rajon disa nga përfitimet përpara anëtarësimit, duke nxitur rritjen ekonomike dhe përshejtimin e konvergjencës socio-ekonomike, ka identifikuar shtatë fusha prioritare fillestare, dy nga të cilat prekin çështjet e kapitujve të përfshirë në grupimin 4, dhe janë: i) integrimi i transportit rrugor, ii) integrimi i tregjeve të energjisë.

Bazuar në këtë Plan, ka nisur përgatitja e Agjendës Kombëtare të Reformave bazuar në rekomandimet e KE, duke përfshirë Paketën vjetore të Zgjerimit dhe konkluzionet e Dialogut Ekonomik dhe Financiar, bazuar në Programet e Reformës Ekonomike të vendeve (ERP). Zhvillimi i infrastrukturave madhore ekonomike mbetet në qendër të masave investuese në kuadër të kësaj Agjende, për të siguruar forcimin e lidhjes me BE-në, Rrjetet Evropiane dhe me rajonin.

Procesi screening për grupimin e katërt filloi zyrtarisht në mars të vitit 2023 dhe u finalizua në shtator të vitit 2023. Të gjitha strukturat negociuese të përfshira në grupimin e katërt kanë bërë një punë të mirë dhe intensive për finalizimin e procesit screening (takime bilaterale), brenda 7 muajve (mars – shtator 2023). Përgjatë periudhës raportuese, për çdo kapitull respektivisht kanë filluar përgatitjet dhe analiza për hartimin e draft pozicionit negociues për grupimin e katërt. Ende pritet të përcillet Raporti *Screening* nga KE për këtë grupim, ndaj gjatë periudhës raportuese institucionet e përfshira janë angazhuar në dhënien e përgjigjeve të pyetjeve plotësuese të shërbimeve të Komisionit, dhe DG-ve përkatëse, në lidhje me saktësime të mëtejshme mbi çështje specifike, duke vënë në dispozicion kështu informacionin më të azhurnuar që KE do të përdorë për finalizimin e Raportit *Screening*.

Gjatë periudhës Prill-Qershor 2024 janë zhvilluar 4 takime, në 4 GNPIE-të e Grupimit IV “Agjenda e Gjelbër dhe Lidhshmëria e Qëndrueshme”, ku janë të angazhuar rreth 274 anëtarë. Disa nga çështjet që mekanizmi i qeverisjes për integrimin evropian për Grupimin IV “Agjenda e Gjelbër dhe Lidhshmëria e Qëndrueshme”, ka ndjekur gjatë kësaj periudhe raportuese lidhen me (i) Ndjekja e ecurisë së akteve të parashikuar në PKIE 2024-2026 për vitin 2024; (ii) finalizimi i kontributit për takimin e 15-të i Nënkomitetit “Transporti, Energjia, Mjedi dhe Zhvillimi Rajonal”, 11 qershor, 2024; (iii) Plotësimin e formatit të databazës e Future Plans, Accelerated Integration bazuar në takimet bilaterale; (iv) Përdorimi i sistemit

TIK nga strukturat e integritit si dhe nga anëtarët e GNPIE për kapitullin 15 “Energjia” (v) përditësimi i dokumentit të blerësimit të boshllëqeve ligjore me ndryshimet legjislative dhe ndryshimet në Direktivat Rregulloret; (vi) përditësimi i procesit për përditësimin e dokumentit të analizës së ardhshme institucionale dhe administrative të hendeqeve.

Arritjet kryesore gjatë periudhës raportuese për Grupimin 4, në zbatim të rekomandimeve të Komisionit paraqiten, si më poshtë vijon:

*Në fushën e transportit dhe energjisë, ka vijuar puna për përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis* e BE-së, si një nga rekomandimet e vazhdueshme të Komisionit Evropian, duke u miratuar aktet si më poshte vijon:*

- Urdhëri i Ministrit të Transportit dhe Energjisë nr. 79, datë 15.04.2024 "Për miratimin e rregullores mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra", e cila përafron plotësisht Rregulloren e Komisionit (BE) nr. 1321/2014, e datës 26 nëntor 2014, mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra;
- Urdhëri i Ministrit të Transportit dhe Energjisë nr. 83, datë 22.4.2024 "Për disa ndryshime në Urdhrin e Ministrit Nr.42 i datës 27.03.2023 "Për përcaktimin e rregullave të përbashkëta të ajrit dhe dispozitat operacionale në lidhje me shërbimet dhe procedurat në lundrimin ajror", i cili përafron plotësisht Rregulloren e Komisionit (BE) 2023/1772 e 12 Shtatorit 2023 e cila ndryshon rregulloren e zbatimit (BE) Nr. 923/2012 për përcaktimin e rregullave të përbashkëta të ajrit dhe dispozitat operacionale në lidhje me shërbimet dhe procedurat në lundrimin ajror dhe shfuqëzimin e rregullores (BE) Nr.1033/2006;
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 411, datë 19.06.2024 "Për miratimin e Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil".
- *Në fushën e energjisë:* U miratua në datë 16.05.2024 Ligji Nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji", i cili është përafruar plotësisht me rregulloren (BE) 2017/1369 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 4 korrik 2017, "Për përcaktimin e kuadrit ligjor për etiketimin e energjisë dhe shfuqizimin e direktivës 2010/30/BE".
- *Në fushën e mjedisit:*
 - U miratua Ligji i ri nr. 29, datë 04.04.2024, "Për burimet ujore";
 - Në nënfushën e cilësisë së ajrit është miratuar urdhri i Kryeministrit nr. 98, datë 20.06.2024 "Për Ngritjen e Komisionit Kombëtar për Ajrin e Pastër";
 - Përsa i përket nënfushës së mbetjeve, Shqipëria mori pjesë në takimin e katërt të Komitetit Ndërqeveritar Negociator (INC-4) për Zhvillimin e një Instrumenti Ndërkombëtar Ligjor Detyruar për Ndotjen Plastike, duke përfshirë Mjedisin Detar, mbajtur në 23-29 Prill 2024;
- *Në nënfushën e kimikateve* është përgatitur draft vendimi i Këshillit të Ministrave për ngritjen e Regjistrimit Kombëtar Elektronik të Kimikateve, si një angazhim që rrjedh nga Ligji 27/2016 "Për menaxhimin e kimikateve".

2.5 Grupimi i pestë i kapitujve "Burimet, bujqësia dhe kohezioni"

Në përputhje me metodologjinë e re të Bashkimit Evropian për zgjerimin, grupimi 5 "Burimet, bujqësia dhe kohezioni social" paraqet një rëndësi të veçantë për Shqipërinë. Ai mbulon fusha të rëndësishme si bujqësia dhe zhvillimi rural (kapitulli 11) dhe peshkimi (kapitulli 13 + kapitujt 22 & 33). Legjislacioni evropian në këta sektorë synon ngritjen e sistemeve të

qëndrueshme të furnizimit të ushqimit, përdorimit të metodave digjitale, inovative të përdorimit të burimeve, si dhe reduktimin e pesticideve dhe fertilizuesve, në kuadër të mbrojtjes së mjedisit, rregullime specifike për sigurinë ushqimore, politikat veterinarë dhe fitosanitare (kapitulli 12), politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore (kapitulli 22), parashikimet financiare dhe buxhetore (kapitulli 33).

Procesi *screening* për Grupimin e pestë filloi zyrtarisht në korrik të vitit 2023 dhe u finalizua në nëntor të vitit 2023.

Gjatë periudhës Prill-Qershor 2024 janë zhvilluar 17 takime, në 5 GNPIE-të e Grupimit V “Burimet, Bujqësia dhe Kohezioni, ku janë të angazhuar rreth 201 anëtarë. Disa nga çështjet që mekanizmi i qeverisjes për integrimin evropian për Grupimin V “Burimet, Bujqësia dhe Kohezioni”, ka ndjekur gjatë kësaj periudhe raportuese lidhen me (i) Finalizimin e kontributit të kërkuar për kontributin e parë të Progres Raportit për periudhën Shtator 2023 – Mars 2024; (ii) Ndërgjegjësim mbi ecurinë e përdorimit të sistemit MIS ; (iii) Ndërgjegjësim mbi zbatimin e rekomandimeve të KE sipas Raportit 2023 dhe mbi raportimet periodike; (iv) monitorimin e vazhdueshëm të PKIE -së për të miratuar brenda afateve aktet ligjore të parashikuara për vitin 2024; (v) Plani i punës për vitin 2024 të GNPIE-së; (vi) Analiza e pyetjeve të dërguara nga DG REGIO; (vii) finalizimi i dokumentit për Future Plans; (viii) monitorimi i prioriteteve sipas planifikimit të Paketave Semestrale për tremujorin e parë, etj.

Arritjet kryesore gjatë periudhës raportuese të Grupimit të pestë të kapitujve “Burimet, bujqësia dhe kohezioni”, lidhur me rekomandimet dhe negociatat e BE-së paraqiten, si më poshtë vijon:

Në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural: Në përputhje me rekomandimet e Komisionit ka vijuar puna për zbatimin e masave administrative për kapitullin 11 lidhur me sigurimin dhe përmirësimin e regjistrit të fermave për t’u përputhur plotësisht me acquis e BE-së. Për plotësimin e kornizës ligjore për politikën e cilësisë dhe prodhimin e ushqimit organik, është hartuar projektligji "Për prodhimin biologjik dhe etiketimin e produkteve biologjike", ka përfunduar procesi i konsultimit publik, po ndiqen procedurat për miratimin e tij.

Në fushën e sigurisë ushqimore: Ka vijuar hartimi dhe zbatimi i legjislacionit për kontrollin e cilësisë dhe sigurisë së produkteve ushqimore me qëllim integrimin e kontrollit të ushqimit si një funksion kyç në mbrojtjen e shëndetit dhe interesave të konsumatorit, duke siguruar konkurrencë të ndershme në tregun kombëtar dhe futjen e ushqimit dhe produkteve në tregun ndërkombëtar.

Në fushën e peshkimit: - Është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave për propozimin e Projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 64/2012 “Për peshkimin”;

Ka vijuar puna për zbatimin e masave administrative për kapitullin 13 lidhur me hartimin e projekt Vendimit të Këshillit të Ministrave “Për ngritjen e sistemit të inspektimit për parandalimin, shkurajimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të parregulluar dhe të paraportuar (PPP) dhe krijimin e skemës së certifikimit të zënive në peshkim”.

Forcimi e kapaciteteve administrative të nevojshëm në sektorin e peshkimit si dhe për lehtësimin e procedurave dhe minimizimin e dokumenteve për ofrimin e shërbimeve publike në fushën e peshkimit;

Gjithashtu, ka vijuar puna për zbatimin e masave institucionale të kapitullit për ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve në zbatim të VKM Nr.826 datë 28.12.2023 "Për organizimin dhe funksionimin e drejtorisë së shërbimeve të peshkimit dhe akuakulturës", transpozimin e vendimeve të Organizatave Rajonale të Menaxhimit të Peshkimit që lidhen me mundësitë e

peshkimit, për përditësimin e planeve të menaxhimit në fuqi.

Në fushën e zhvillimit rajonal: Grupi Ndërinstitucional i Punës për negociatat e Kapitullit 22 u riorganizua në fillim të vitit 2024 për të përfshirë të gjitha institucionet përgjegjëse për vetëvlerësimin e progresit me kushtet mundësuese të vendosura sipas Rregullores së BE-së 2021/1060 neni 15. Një nëngrup specifik i grupit ndërinstitucional të punës është krijuar për të mbuluar Kushtet Mundësuese, i përbërë nga 11 institucione.

Në zbatim të ligjit Nr. 102/2020 “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, po vijon punën për plotësimin e akteve nënligjore dhe zbatimin e tyre; tre Vendime të Këshillit të Ministrave janë hartuar dhe procesi zyrtar i miratimit të tyre nga Këshilli i Ministrave, ka nisur.

2.6 Grupimi i gjashtë i kapitujve “Marrëdhëniet me jashtë”

Në përputhje me metodologjinë e re të Bashkimit Evropian për zgjerimin, grupimi i 6-të i kapitujve të negociatave mbulon dy kapituj kryesorë: kapitulli 30 “Marrëdhëniet me jashtë” dhe kapitulli 31 “Politika e jashtme e sigurisë dhe e mbrojtjes”.

Procesi *screening* për grupimin e gjashtë filloi zyrtarisht në shtator të vitit 2023 dhe u finalizua në nëntor të vitit 2023.

Komisioni Evropian pritet të përcjellë Raportin *Screening* për këtë grupim, ndaj gjatë periudhës raportuese institucionet e përfshira janë agazhuar në përgatitjen e draftit të parë të pozicionit negociues bazuar në takimet bilaterale screening dhe raportet e tjera të Komisionit Evropian për këtë grupim.

Gjatë periudhës Prill-Qershor 2024 janë zhvilluar rreth 2 takime, në 2 GNPIE-të e Grupimit VI “Marrëdhëniet me jashtë”, ku janë të angazhuar rreth 75 anëtarë.

Më specifikisht, në 2 takimet e zhvilluara të mekanizmit për Grupimin VI “Marrëdhëniet me Jashtë”, disa nga çështjet e trajtuar, diskutuar dhe konsultuar lidhen me (i) hartimi i draft Pozicionit Negociues; (ii) State of Play i Kapitullit 31; (iii) pyetësori i vetëvlerësimit institucional për vlerësimin e kapaciteteve dhe strukturave për integrimin evropian; (iv) diskutime lidhur me arritjet dhe rezultatet e indeksve të raportit 3 mujorit të dytë PSIE 2024.

Arritjet kryesore gjatë periudhës raportuese të Grupimit të gjashtë të kapitujve “Marrëdhëniet me jashtë”, lidhur me rekomandimet dhe negociatat e BE-së paraqiten, si më poshtë vijon:

- Shqipëria vazhdon të mbetet 100% e linjësuar me Deklaratat e Përfaqësuesit të Lartë, në emër të BE-së si dhe me Vendimet e Këshillit të BE-së për masat kufizuese. Shqipëria zbaton në territorin shqiptar vendimet e Këshillit të BE-së, për masat kufizuese. Ekziston baza ligjore, struktura institucionale dhe procedurat e linjësimit politik dhe zbatimit praktik të sanksioneve të BE-së në Shqipëri.
- Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe të zhvillimit si dhe ndihmën humanitare, grupi ndërinstitucional i punës i ngritur me qëllim hartimin e kuadrit ligjor dhe ndarjen e përgjegjësive institucionale, ka hartuar një draft të dokumentit të politikave, i cili do të përcaktojë strukturat relevante dhe vendosë standarde në përputhje me politikat e BE-së. Ky draft është në proces vlerësimi nga institucionet përkatëse.
- Në qershor 2024, u realizua anëtarësimi i Shqipërisë në Qendrën e Ekselencës për

Kërcënimet Hibride, në Helsinki. Anëtarësimi i Shqipërisë në këtë qendër përbën një hap të rëndësishëm në angazhimin e vendit tonë për sigurinë e përbashkët me aleatët e NATO-s dhe vendet anëtare të BE-së.

2.7 Trajnime dhe forcimi i kapaciteteve të strukturave të integritit evropian

Gjatë periudhës Prill-Qershor 2024¹⁰ janë trajnuar 1282 punonjës në fushën e integritit evropian, nga të cilët 776 punonjës nga pushteti qendror, 349 nga pushteti vendor dhe 149 punonjës nga institucionet e pavarura.

Pushtetet	Numri i individëve
Qendror	776
Vendor	349
I pavarur	149
Organizatë apo Kompani private	8
Total	1,282

Gjithashtu, në këtë periudhë janë zhvilluar sesione informuese (me kohëzgjatje 2 orë), ku pjesëmarrës kanë qënë punonjësit nga pushteti qendror, pushteti vendor dhe institucionet e pavarura.

Nr.	Temat e sesioneve informuese	Nr.pjesëmarrësve
1	Bashkimi doganor dhe lëvizja e lirë e mallrave në BE	197
2	E drejta dhe interesat legjitime të strategjive në politikat e punësimit	264
3	IA dhe Impakti i Ligjit evropian mbi shtetet	152
4	Lëvizja e Lirë e Kapitalit	55
5	Lëvizja e lirë e personave në BE	326
6	Levizja e lirë e shërbimeve në BE	183
7	Menaxhimi i fondeve IPA	100
8	Menaxhimi i risqeve në fondet IPA dhe Qëndrueshmeria e projekteve	47
9	Metodologjia e re e Zgjerimit të BE-së	159
10	Njohja me aktet juridike evropiane	100
11	Procesi i zgjerimit të BE drejt Ballkanit Perëndimor	105
12	Pushteti gjyqësor në BE dhe lidhja me gjyqësorin e brendshëm të shteteve anëtare	38
13	Raporti i të drejtës Evropiane me të drejtën kombëtare	50

¹⁰ Trajnime të bashkërenduara nga ASPA: Numri i pjesëmarrësve në këtë raport llogaritet sipas numrit të herëve që një individ ndjek trajnime.

PJESA III: PJESËMARRJA E GRUPEVE TË INTERESIT NË PROCESIN E NEGOCIATAVE DHE INTEGRIMIT EVROPIAN

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian është një proces gjithëpërfshirës mbarëkombëtar, me ndikim në të gjithë grupet e interesit dhe ekonominë tonë. Në përputhje me vendimin nr.749 datë 19.12.2019 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe përfundimin e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian (PPIE) është mekanizmi kryesor për informimin, konsultimin, komunikimin dhe përfshirjen e shoqërisë civile, grupeve të interesit, etj në nismat në procesin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, si dhe në procesin e stabilizim-asociimit.

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 749, datë 19.12.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse, për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian” si dhe Urdhrit të Kryeministrit nr.113 datë 30.08.2019 “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian”, gjatë periudhës raportuese, nga Departamenti i Politikës dhe Integrimt Evropian/Sekretariati i Integritimit Evropian, në bashkërendim me projektin “Mbështetje për Negociatat e Anëtarësimit për Kapitujt Ekonomikë të Acquis”- SANECA II, financuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, zbatuar nga GIZ është iniciuar procesi i vlerësimit të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, për përmirësimin e dialogut përmes PPIE-së, dhe Tryezave të Diskutimit & Këshillimit, për çdo kapitull të *Aquis* dhe kritere, sipas masave të Planit të Veprimit, nxitur nga ky vlerësim.

Në këtë drejtim, si fazë e parë e procesit, u hartua korniza e vetëvlerësimit si dhe bashkërendua puna për t’u plotësuar nga të gjithë anëtarët e PPIE-së. Përmes këtij instrumenti vetëvlerësimi, synohet të paraqitet një vlerësim i nivelit të angazhimit të grupeve të interesit në procesin e integritimit, përmes tryezave të Platformës. Në këtë kuadër, është kryer identifikimi i situatës dhe rekomandimet për përmirësimin e punës së tryezave të konsultimit, për të mundësuar planifikimin në të ardhmen të masave që do të zhvillojnë edhe më tej dialogun e hapur me grupet e interesit, në funksion të një procesi të suksesshëm të negociatave me BE-në.

Gjatë periudhës raportuese (prill – qershor 2024) u konsolidua nga Sekretariati i Integritimit Evropian, me mbështetjen e projektit të BE-së ‘Support for EU Integration’ dhe GIZ, Plani i Veprimit PPIE 2024+, i cili është një mjet operacional që përcakton objektivat dhe aktivitetet për përmirësimin e funksionit dhe të punës të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian (PPIE), gjatë vitit 2024 dhe me tej.

Disa nga masat janë përmirësimi i kuadrit rregullues, rritja e përfshirjes së palëve të interesuara, përdorim i përmirësuar i kanaleve të komunikimit dhe forcimi i kapaciteteve të anëtarëve të Platformës për të mbështetur integrimin të Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE). Aktivitetet në këtë Plan përfshijnë analizim të modeleve europiane dhe përgatitjen e opsioneve për kuadrin rregullator të PPIE, si dhe zhvillimin e rregulloreve të brendshme dhe manualeve teknike. Gjithashtu, do të krijohet një paketë e përdorshme mjetesh/instrumentash për Platformën PPIE (Toolbox).

Grupimi 1 “Themeloret”

Lidhur me funksionimin e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, për periudhën raportuese prill-qershor 2024, rezulton se janë zhvilluar 5 mbledhje/tryeza të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, ku janë trajtuar 5 çështje tematikash dhe me një pjesëmarrje në total të 111 aktorëve/grupeve të interesit si ekspertë të fushës (4), përfaqësuesve nga shoqëria civile (35) dhe përfaqësuesve nga akademia/universitetet (32), përfaqësues të pushtetit vendor (24), përfaqësues të komunitetit të biznesit (10), përfaqësues të medias (4).

Në këto takime janë trajtuar, diskutuar dhe konsultuar çështje lidhur me:

- Objektivat prioritare në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024-2030;
- Menaxhimi i migracionit të parregullt dhe bashkëpunimi me Frontex;
- Agjendën e Reformave, në kuadër të Growth Plan (Plani i Rritjes);
- Promovimi i dialogut të hapur dhe bashkëpunimin mes institucioneve shtetërore dhe aktorëve të shoqërisë civile dhe të rinjve mbi objektivin madhor e strategjik të vendit, siç është procesi i integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Grupimi 2 “Tregu i brendshëm”

Lidhur me funksionimin e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, për periudhën raportuese prill-qershor 2024, rezulton se janë zhvilluar 2 mbledhje/tryeza të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, ku janë trajtuar 10 çështje tematikash dhe me një pjesëmarrje në total të 44 aktorëve/grupeve të interesit si ekspertë të fushës (1), përfaqësuesve nga akademia/universitetet (32), përfaqësues të komunitetit të biznesit (11).

Në këto takime janë trajtuar, diskutuar dhe konsultuar çështje lidhur me:

- Ecuria e procesit të negociatave dhe roli i aktorëve të interesit;
- Angazhimet e Shqipërisë dhe rekomandimet e Raportit të Komisionit Europian 2023;
- Roli dhe rëndësia e angazhimit të dhomave në tryezat e konsultimit;
- Strategjia Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2022 – 2025;
- Reforma ligjore në fushën e pronësisë industriale dhe aktet e reja/të pritshme në kuadër të reformës ligjore për pronësinë industriale;
- Kontributi i dhomave në reformën ligjore;
- Prezantimi i instrumentit të vetëvlerësimit për NVM – të dhe start up-et (WIPO IP prediagnostic);
- Roli dhe kontributi i Institucioneve të Arsimit të Lartë në procesin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025.

Grupimi 3 “Konkurrueshmëria dhe rritja gjithpërfshirëse”

Lidhur me funksionimin e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, për periudhën raportuese prill-qershor 2024, rezulton se janë zhvilluar 6 mbledhje/tryeza të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, ku janë trajtuar 6 çështje tematikash dhe me një pjesëmarrje në total të 69 aktorëve/grupeve të interesit si ekspertë të fushës (45), përfaqësuesve nga shoqëria civile (11) dhe përfaqësuesve nga akademia/universitetet (5), përfaqësues të komunitetit të biznesit (8).

Në këto takime janë trajtuar, diskutuar dhe konsultuar çështje lidhur me:

- Dialogu Ekonomik dhe Financiar, në kuadër të procesit të negociatave;

- “Platforma e Angazhimit për Bashkëpunimin Konstruktiv” për një qasje të integruar në adresimin e sfidave për përfshirjen efektive në shoqëri, në arsim dhe punësim për komunitetet e marginalizuara Rome dhe Egjiptiane “Inclusive EduJobs”;
- Informimi në kuadër të Programit Digjital të BE-së EDIH;
- Konsultimi i Agjendës së Reformave për Growth Plan, me temë diskutimi “Tranzicioni Digjital” dhe me temë “Promovimi i përfshirjes digjitale dhe Aksesibilitetit”;
- Sesion informues mbi thirrjet e hapura të Programit Digjital të BE-së.

Grupimi 4 “Agjenda e Gjelbër dhe Ndërlidhja e Qëndrueshme”

Lidhur me funksionimin e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, për periudhën raportuese prill-qershor 2024, rezulton se janë zhvilluar 3 mbledhje/tryeza të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, ku janë trajtuar 8 çështje tematikash dhe me një pjesëmarrje në total të 13 aktorëve/grupeve të interesit si përfaqësuesve nga shoqëria civile (6) dhe përfaqësuesve nga akademia/universitetet (2), përfaqësues të shoqatave të punëmarrësve (5).

Në këto takime janë trajtuar, diskutuar dhe konsultuar çështje lidhur me:

- Tryezat për platformën e partneritetit për integrimin evropian me temë: “Mbi etiketimin e produkteve me ndikim në energji”;
- Situata aktuale lidhur me procesin e integritit Evropian, Kapitulli 15 “Energjia” dhe 21 “Rrjetet-transevropiane”, veçanërisht në kuadër të Programit Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian (PKABE) 2030 dhe PKIE 2024-2026.
- Çështje të takimit të 15-të i Nënkomitetit “Transporti, Energjia, Mjedisi dhe Zhvillimi Rajonal”, 10 qershor, 2024;
- Paketa e Raportit Kombëtar të Veprimtarisë GNPIE & Vlerësimit të Indeksit të Kapaciteteve të Integritit Evropian për 3-mujorin Janar-Mars 2024;
- Promovimi i përfshirjes digjitale dhe aksesibilitetit lidhur me (i) aftësimi digjital dhe përmirësimi i aftësive si dhe (ii) përfshirja dhe aksesueshmëria.

PJESA IV: INTEGRIMI EVROPIAN NË NIVEL VENDOR

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian është një proces kompleks dhe gjithëpërfshirës, i cili bëhet realitet nëpërmjet kontributit të të gjitha niveleve të qeverisjes dhe të gjithë shoqërisë. Integrimi në Bashkimin Evropian kërkon edhe angazhimin & rolin e pushtetit vendor.

Për të adresuar sa më sipër, një sërë masash janë ndërmarrë gjatë periudhës raportuese për të mbështetur bashkitë dhe administratën e tyre në rritjen e kapaciteteve institucionale dhe administrative lidhur me procesin e integrimit evropian.

4.1. Ngritja e kapaciteteve institucionale mbi integrimin evropian

4.1.1. Dialogu Vendor

Procesi i integrimit evropian është një prej prioriteteve kryesore të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore. Në këtë kuadër, me iniciativë të Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, AMVV ka zhvilluar aktivitete të shumta, në bashkëpunim me projektin Bashkitë për në Evropë.

1. Njësitë e Integrimit Evropian (NjIE) në nivel vendor

NjIE me mangësi në ekip vijon të ketë në bashkitë e Poliçanit, Skraparit dhe Konispolit, por janë vendosur pika kontakti të përkohshme.

2. Ofrimi i trajnimeve

Gjatë periudhës raportuese, veprimet për ngritjen e kapaciteteve u përqëndruan në trajnimet si vijon në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), për (i) mentorim të Bashkive që janë duke zbatuar projekte dhe asistencë (ii) trajnim për Menaxhimin Financiar të Projekteve të BE-së me ekspertë ndërkombëtarë (iii) trajnim me këshillat bashkiakë (iv) mbështetje për thirrjet e reja për aplikime, në kuadër të programeve evropiane dhe atyre të IPA CBC. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar trajnimet e mëposhtme:

Tablea 1 : Tabela përmbledhëse e trajnimit të ofruar Prill – Qershor 2024

Nr.	Trajnimet	Vendi	Nr. Trajnimeve	Datat	Nr. bashkive	Nr. pjesëmarrësve
1	Trajnimi për PRAG - bashkitë e Rajoneve Lezhë, Shkodër, Kukës	Shkodër	2	4-5-6-7-8 Mars	1 1	34
2	Trajnimi për Menaxhimin Financiar të Projekteve të BE-së – bashkitë erajoneve	Tirana	1	18-19-20 Mars	8	14
3	Trajnime Mentoruese me Bashkitë për Zbatimin e Projekteve: Tirana, Tepelena (online), Lezha, Klos (online),Mirdite	Tiranë	5	26-28 Mars	5	12
4	Trajnime Mentoruese me Bashkitë për Zbatimin e Projekteve – Roskovec	Roskovec	1	29 Mars	1	6

5	Trajnimi për Menaxhimin Financiar të Projekteve të BE-së – bashkitë erajoneve	Tiranë	2	22-23-24-25-26 Prill	2 2	44
	Trajnimi Rajonal me Këshillat Bashkiakë për Integrimin Evropian dhe Rolin e Bashkive 1	Berat	1	20 Maj	5	27
7	Trajnimi Rajonal me Këshillat Bashkiakë për Integrimin Evropian dhe Rolin e Bashkive 2	Gjirokastër	1	21 Maj	3	16
8	Trajnimi Rajonal me Këshillat Bashkiakë për Integrimin Evropian dhe Rolin e Bashkive 3	Vlore	1	22 Maj	4	16
9	Trajnimi Rajonal me Këshillat Bashkiakë për Integrimin Evropian dhe Rolin e Bashkive 4	Fier	1	23 Maj	6	17

4.2. Analiza e situatës për Komisionet e Integritit në Këshillat Bashkiakë

Një element i rëndësishëm është përfshirja e Këshillit Bashkiak në procesin e integritit, duke ngritur Komisionet e Integritit si komisione të përhershme të këshillave bashkiakë, si dhe përfshirja në rregulloret e brendshme të këshillave duke përcaktuar në këtë rregullore detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit të Integritit.

Ngritja e këtyre Komisioneve (54 Komisione të ngritura tashmë) pranë këshillave bashkiakë kërkon një vëmendje të shtuar për trajnimin e anëtarëve të rinj të këtyre komisioneve.

Në funksion të rritjes së kapaciteteve u organizuan 5 trajnime rajonale në 5 rajone të ndryshme me target anëtarët e Komisionit të Integritit, në disa raste, e kombinuar me punonjës të njësisë së integritit në bashki të ndryshme.

Në kuadër të këtij objekti gjatë muajit Maj 2024 u realizuan trajnime rajonale në Berat, Gjirokastër, Vlorë, Fier, Elbasan.

Çështje kryesore objekt i trajnimit të cilat u diskutuan me pjesëmarrësit:

- Roli i Bashkive në procesin e Integritit në BE dhe mbështetja e BE lidhur me zhvillimin ekonomik dhe social në nivel vendor;
- Procesi i Integritit në BE si një mundësi unike për të modernizuar administratat vendore bazuar në principet e qeverisjes së mirë;
- Fondet dhe politikat e Kohezionit të BE. Kontributi dhe përfitimet e Qeverisjes Vendore – Eksperienca nga vendet e BE;
- Roli i zyrtarëve të zgjedhur në negociatat lidhur me Kapitullin 22 në Procesin e Anëtarësimit.;
- Hapat që duhet të ndërmerren për të siguruar angazhimin e Këshillave Bashkiakë në procesin e integritit në BE në nivel vendor.

Më poshtë gjendet një informacion lidhur me takimet sipas rajoneve:

20 Maj 2024 - Trajnim Rajonal në Bashkinë Berat

- Në këtë trajnim morën pjesë anëtarët e Komisionit të Integritit të Këshillave Bashkiakë nga bashkitë Berat, Dimal, Skrapar, Poliçan, Kuçovë. Numri i pjesëmarrësve, 22 persona, nga këta 19 anëtarë nga komisionet e Integritit, dhe 3 përfaqësues të njësisë së Integritit .

21 Maj 2024 - Trajnim Rajonal në Bashkinë Gjirokastrë

- Pjesëmarrës në trajnim ishin anëtarët e Komisionit të Integritit të Këshillave nga bashkitë Gjirokastrë, Dropull, Tepelenë. Numri i pjesëmarrësve 11 persona: nga këta 5 anëtarë komisioni dhe 6 persona nga personeli i bashkisë. Bashkia Gjirokastrë nuk ka ngritur Komisionin e Integritit; këshilli është në procesin e krijimit të Komisionit të Integritit.

22 Maj 2024 - Trajnim rajonal në Bashkinë Vlorë

- Në këtë trajnim morën pjesë anëtarët e Komisionit të Integritit të Këshillave bashkiakë nga bashkitë Vlorë, Delvinë, Konispol, Selenicë. Numri i pjesëmarrësve: 11 persona, nga të cilët 9 anëtarë nga Komisionet e Integritit dhe 2 përfaqësues të njësisë së integritit.

23 Maj 2024 - Trajnim Rajonal në Bashkinë Fier

- Në këtë trajnim morën pjesë anëtarët e Komisionit të Integritit të Këshillave Bashkiakë nga bashkitë Fier, Lushnje, Divjakë, Patos, Roskovec, Mallakastër. Numri i pjesëmarrësve: 13 persona, nga të cilët, 12 anëtarë nga komisionet e integritit dhe 1 përfaqësues - sekretar i Këshillit.

24 Maj 2024 - Trajnim Rajonal në Bashkinë Elbasan

- Pjesëmarrës në trajnim anëtarët e Komisionit të Integritit të këshillave nga bashkitë Elbasan, Belsh, Librazhd, Cërrik. Numri i pjesëmarrësve: 8 persona anëtarë të Komisionit të Integritit të Këshillave.

Hapa të mëtejshme në periudhat në vijim:

- Vazhdimësia e trajnimeve me anëtarët e Komisioneve të Integritit ,e koordinuar dhe me pjesëmarrjen e njësisë të Integritit në bashki;
- Ndërtimi i komunikimeve të vazhdueshme midis njësisë së integritit me Komisionin e Integritit në bashki, si dhe organizimi i aktiviteteve të përbashkëta;
- Krijimi i Rrjeteve të Komisioneve të Integritit në bashki të ndryshme dhe organizimi i aktiviteteve informuese, si dhe ndarje e eksperiencës me vendet e tjera;
- Përfshirje më e madhe e Komisioneve të Integritit në këshillat bashkiakë në proceset e negociatave, nëpërmjet konsultimit të dokumentave dhe qëndrimeve të ndryshme që lidhen më kapituajt e acquis, ku pushteti vendor ka një rol të rëndësishëm.

Ju faleminderit,

Grupi Negociator,
Departamenti i Politikës dhe Integritit Evropian (Sekretariati i Integritit Evropian)

Korrik, 2024